



E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2001

Në këtë numër:

Opinione për Politikat Ligjore

- Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë: vështrim ligjor

E Drejta Parlamentare

- KEDNJ dhe legjislati i brendshëm
- Procesi i rregullt ligjor në këndvështrimin e Gjykatës Kushtetuese
- Vetoja e Presidentit në procesin legjislativ

4

Botimi i Qendres Studimore
Mbi Praktikën Parlamentare
Dhe Demokratike

PERMBAJTJA E REVISTES:

Numri IV, viti 2001

Faqe

Opinione mbi politikat ligjore:

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në këndvështrimin ligjor

- | | |
|---|----|
| - Sokol SADUSHI, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese | 5 |
| - Sokol LAMAJ, Drejtor i Drejtorisë Juridike
në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve | 17 |

E Drejta Parlamentare:

- | | |
|--|----|
| - Konventa Europjane e të Drejtave të Njeriut dhe
Legjislacioni i Brendshëm, Prof. Arben PUTO | 24 |
| - Kërkesa e Kushtetutës rreth “Procesit
të rregullt ligjor”, Alfred KARAMUÇO | 32 |
| - Roli i Presidentit të Republikës në procesin
ligjvënës. Vetoja është instrument politik
apo instrument kushtetues? Theodhori SOLLAKU | 42 |

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend, Filip LAKO 48

Informacion mbi veprimtaritë e organizmave ndërkombëtare, Leon SHESTANI 63

Përmbledhje e përkthyer në anglisht: 66

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

TABLE OF CONTENTS:

4th Issue, year 2001

	Page
<hr/>	
Opinions about Legal Policies:	
Elections for the Parliament of Albania	
- Sokol SADUSHI, Member of Constitutional Court	5
- Sokol LAMAJ, Director of Legal Department in the Central Election Commission	17
<hr/>	
Parliamentary Law:	
- European Convention of Human Rights and its Internal Legislation, Prof. Arben PUTO	24
- Constitutional obligation about “The Right Legal Process”, Alfred KARAMUÇO	32
- Role of the President of the Republic in the legislating process. Veto is a political or a constitutional instrument? Theodhori SOLLAKU	42
<hr/>	
Information on laws passed by Assembly Filip LAKO	48
<hr/>	
Information about International Assemblies’ Activities, Leon SHESTANI	63
<hr/>	
Summary in English :	66
Information about Laws passed by the Assembly	


Kjo rubrikë synon paraqitjen e politikave ligjore, në mënyrë të paanshme dhe objektive. Publiku dhe subjektet e interesuara duhet të jenë të qartë për debatin politik dhe për qëndrimet e forcave të ndryshme politike për çështje të rëndësishme që prekin interesa të një kategorie të gjerë njerëzish.

Në këtë numër të Revistës është përzgjedhur çështja e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë. Duke patur parasysh karakterin e theksuar politik në qëndrimet e forcave politike ndaj kësaj çështjeje, vlerësuam si më me interes paraqitjen e dy opinionëve, në një këndvështrim ligjor dhe institucional.

Procesi Zgjedhor dhe Gjykata Kushtetuese

Sokol Sadushi

Anëtar i Gjykatës Kushtetuese



Zgjedhjet përcaktojnë nivelin e demokracisë në shoqëri. Mënyra e zhvillimit të tyre ndikon drejtpërdrejt në sistemin e të qeverisurit. Zgjedhjet, duke pasur një ndikim thelbësor në zhvillimet politike, ekonomike e sociale të vendit, bëhen objekt pranimi, por edhe kontestimi, në radhë të parë nga vetë faktorët relevantë që janë dhe aktorë të realizimit të saj ose edhe nga vetë shoqëria. Si të tilla, zgjedhjet nuk mund të jenë të pakontrollueshme.

Mënyra e zhvillimit të zgjedhjeve, si dhe verifikimi i rezultatit të tyre është një proces i tërë kontrolli që kërkon detyrimisht zbatimin dhe përmbushjen me përpikëri të detyrimeve ligjore nga subjektet politike ose shtetërore, të cilat luajnë rolin përcaktues në to. Fillimisht, komisioneve zgjedhore të të gjitha hallkave, e më pas gjykatave, u mbetet pesha dhe përgjegjësia kryesore e realizimit korrekt, të paanshëm dhe ligjor të kontrollit administrativ dhe gjyqësor mbi zgjedhjet.

Nga një vështrim tërësor i procesit zgjedhor u vërejt se nga shqyrtimi me disa mangësi i ankesave administrative nga komisionet zgjedhore, për shkak të konceptimit të tyre më shumë si organe me varësi partiake se shtetërore, qoftë dhe për arsye të formulimit të paqartë të disa dispozitave

ligjore, nuk mund të parandalohej fluksi i jashtëzakonshëm i kërkesave të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese. Në këto kushte ky institucion kushtetues u vu përballë shfrytëzimit ligjor të së drejtës së ankimit nga ana e kandidatëve për deputetë, si dhe të trysnisë së jashtëzakonshme politike, mediatike dhe ligjore (e cila shprehej në afatin mjaft të shkurtër të zgjidhjes së çështjeve). Prandaj dhe menaxhimi me kujdes, korrektesë dhe sipas kërkesave ligjore i këtyre çështjeve u realizua në një kohë të përshtatshme, pa penguar zhvillimin normal të procesit zgjedhor.

Ka pasur disa keqkuptime, për fat të keq edhe nga juristë, në drejtim të pozicionit juridiksional të Gjykatës Kushtetuese ndaj procesit zgjedhor, duke e interpretuar veprimtarinë procedurale, si një teprim në kompetencat e saj. Megjithatë, Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor kanë autorizuar Gjykatën Kushtetuese që të realizojë shqyrtimin gjyqësor të çështjeve që lidhen me zgjedhjen e deputetëve. Dhe në këtë aspekt kjo nuk përbën një problem të diskutueshëm juridiksional.

Duke qenë i rezervuar për shkak të funksionit kushtetues që kryej, për të shprehur opinionin tim vetjak për disa rregullime ligjore që i duhen bërë detyrimisht në të ardhmen Kodit Zgjedhor, do të paraqes nëpërmjet këtyre radhëve, një vështrim konstatues për kompetencën dhe jurisprudencën e ndjekur nga Gjykata Kushtetuese gjatë procesit zgjedhor.

* * *

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në pjesën e parimeve themelore i referohet sistemit të zgjedhjeve. Neni 131 shkronja “e” e Kushtetutës është e vetmja dispozitë që përcakton kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, për të vendosur për çështjet që lidhen *me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve*, si dhe për të verifikuar zgjedhjen e tyre. Në këtë dispozitë përfshihen tri forma të kontrollit kushtetues që ushtron kjo gjykatë.

Papajtueshmëria në ushtrimin e funksioneve të deputetëve është një kompetencë që nuk lidhet drejtpërdrejt me kontrollin që Gjykata Kushtetuese

ushtron gjatë procesit zgjedhor, pasi ajo ushtrohet mbasi deputeti është zgjedhur. Inicimi i kësaj procedure realizohet nga Kuvendi kur ai vëren një nga rastet e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetit dhe përsa kohë vazhdon mandati i tij.

Gjithashtu, edhe kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve nuk është e njëllajtë dhe nuk mund të konfondohej me verifikimin që ajo i bën zgjedhjes së tyre. Kjo procedurë që ndiqet nuk është e njëjtë me shqyrtimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Në rast se pazgjedhshmëria ose papajtueshmëria vërehen pasi deputeti është zgjedhur, mund të ndodhemi përpara një pavlefshmërie, e cila nuk trajtohet si pavlefshmëri e zgjedhjes, por si mbarim ose pavlefshmëri mandati.

Mund të jenë elemente të pavlefshmërisë së një vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të shpalljes së pavlefshme të zgjedhjeve në një zonë të caktuar rastet e pazgjedhshmërisë ose të papajtueshmërisë së deputetëve, në rast se ato vërehen gjatë procesit zgjedhor. Megjithatë, nga pikëpamja formale ato mbeten kompetenca të dallueshme nga njëra tjetra. Prandaj nuk është objekt i këtij shkrimi verifikimi i rasteve të papajtueshmërisë dhe të pazgjedhshmërisë së deputetëve, *por verifikimi i rezultatit të zgjedhjes së tyre, si dhe pavlefshmëria e zgjedhjeve.*

Në asnjë nga dispozitat e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë nuk përmendet termi *pavlefshmëri e zgjedhjeve*. Një formulim i përafërt ka qenë parashikuar edhe në dispozitat e mëparshme kushtetuese, sipas të cilave Gjykata Kushtetuese zgjidhte çështjet për ligjshmërinë e zgjedhjes së deputetëve. Pavarësisht nga ky ometim formal kushtetues, e drejta e gjykatës, për të shfuqizuar aktet që shqyrton, e nënkupton pavlefshmërinë.

Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të kryer verifikimin e zgjedhjes së deputetëve, siç parashikohet në shkronjën “e” të nenit 131 të Kushtetutës, realizohet duke gjykuar mbi vlefshmërinë e aktit që shqyrton. Ajo nuk mund të kryejë verifikimin e rezultatit të zgjedhjeve nëse nuk do t’i paraqitet për shqyrtim një akt. Pra, formulimi aktual kushtetues i kompetencës së kësaj gjykate për të verifikuar zgjedhjen e deputetëve është konsideruar i

mjaftueshëm për ligjvënësin që nëpërmjet Kodit Zgjedhor të zërthejë konceptin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, rastet se kur ndodhemi para saj, si dhe procedurat përkatëse që ndiqen për të shpallur pavlefshmërinë.

Kodi Zgjedhor vetëm në dy nene dhe konkretisht në nenin 113 pika 5 dhe 141 pika 1 parashikon të drejtën e personave të interesuar për t'u ankuar ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Gjykatën Kushtetuese, si dhe të drejtën e kësaj gjykate për të shqyrtuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin, si dhe pavlefshmëritë e tyre.

Në Kod janë parashikuar nëpërmjet shumë dispozitave kërkesat juridike që përcaktojnë ligjshmërinë e procesit zgjedhor dhe të akteve që nxjerrin komisionet zgjedhore. Përfundimin ligjor se vendimet që nxirren nga KZQV-ja ose KZZ-ja, janë ose jo në përputhje me ligjin e nxjerr KQZ-ja, ndërta për vendimin e kësaj të fundit shprehet Gjykata Kushtetuese për zgjedhjet e përgjithshme dhe Gjykata e Lartë për zgjedhjet vendore.

Në Kodin Zgjedhor nuk ka ndonjë rregullim të hollësishëm të rasteve se kur zgjedhjet janë të pavlefshme. Neni 113 jep dy raste të specifikuara të shpalljes së pavlefshmërisë, të cilat lidhen me fatkeqësitë natyrore me përmasa të tilla që mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandateve në Kuvend dhe në rezultatit e zgjedhjeve, si dhe kur votimi nuk ka filluar ose është ndërprerë për më shumë se gjashtë orë. Të provuarit e këtyre dy rasteve, mendoj se nuk paraqet ndonjë vështirësi në trajtimin juridik për të kuptuar se kur KQZ-ja duhet t'i shpallë të pavlefshme zgjedhjet. Përkundrazi, nocioni “shkelje e ligjit” që sjell pavlefshmërinë e zgjedhjeve, i parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni, e bën më të vështirë konstatimin e një rasti të tillë. Prandaj komenti ose interpretimi i shprehjes *shkelje e ligjit* mbetet kurdoherë i rëndësishëm për t'u trajtuar.

Ky nen duke përdorur termin “shkelje ligji”, pa e specifikuar llojin e shkeljes, e ka trajtuar pavlefshmërinë në përgjithësi. Mjafton që të vërehet shkelja e ligjit nga organi që shqyrton çështjen që akti të shpallet i pavlefshëm. Megjithatë, jo çdo shkelje ligji sjell detyrimisht pavlefshmëri. Ligji ka parasysh *vetëm ato shkelje që në të vertetë ndikojnë në rezultatit e*

zgjedhjeve. Në vendimin nr.79/2001, Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar kërkesën e paraqitur nga kandidati për deputet i zonës zgjedhore nr.44, duke argumentuar se “shkeljet e konstatuara nuk janë të tilla që të ndikojnë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë.” Ndërsa në çështjen që lidhet me zonën zgjedhore nr.82, Gjykata Kushtetuese vendosi të shfuqizojë vendimin e KQZ-së, sepse mospërfshirja nga ky i fundit në tabelën e rezultateve të të dhënave të katër qendrave të votimit kishte ndikuar drejtpërdrejt në shpalljen padrejtësisht të kandidatit tjetër si fitues.

Pavlefshmëria që shpallet nga KQZ-ja sipas nenit 113 të Kodit Zgjedhor është e lidhur me rastet e paligjshmërisë së aktit. Shqyrtimi i paligjshmërisë së aktit vlen edhe për Gjykatën Kushtetuese, pasi sipas pikës 5 të këtij neni, ajo bën shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve si rrjedhojë e ankimit ndaj vendimit të KQZ-së. Kontrolli që ushtrohet në këtë rast nga Gjykata Kushtetuese ndaj vendimeve të KQZ-së, ndryshe nga kompetencat e tjera që lidhen me kushtetutshmërinë e normës që shqyrtohet, përqendrohet tek aspekti i *paligjshmërisë*. Megjithatë, edhe kontrolli ndaj paligjshmërisë së aktit që kryen kjo gjykatë është në funksion të kontrollit të kushtetutshmërisë që asaj i buron veçse nga Kushtetuta.

Shqyrtimi i vendimit të KQZ-së nga pikëpamja e paligjshmërisë duket sikur e shndërron Gjykatën Kushtetuese në një gjykatë fakti, duke i shmangur asaj funksionin e një autoriteti të lartë kushtetues. Në të vërtete këto procedura gjykimi janë të njëjta me gjykimet e faktit, pasi ankimet ndaj pavlefshmërisë kërkojnë zgjidhjen e çështjes në themel. Pajisja e Gjykatës Kushtetuese me një kompetencë të tillë duket sikur përbën një përjashtim nga funksioni i kontrollit të kushtetutshmërisë së normës. Sigurisht që ka një qëllim dhënia e kësaj kompetence Gjykatës Kushtetuese. Verifikimi i rezultatit të zgjedhjes së deputetit kërkon një garanci shumë të madhe, sepse për të kanë shprehur vullnetin e tyre zgjedhësit nëpërmjet votës dhe një gjykatë e nivelit të lartë i krijon më shumë premisat për një gjykim të drejtë. Prandaj në gjykimin e këtyre çështjeve Gjykata Kushtetuese zbaton, për aq sa janë të zbatueshëm, parimet dhe normat proceduriale, siç parashikohet

në nenin 1 të ligjit për të. Megjithatë, pajisja me më shumë të drejta e komisioneve zgjedhore për zgjidhjen e çështjeve që dalin gjatë procesit zgjedhor në rrugë administrative, si dhe ingranimi maksimal brenda hapësirave ligjore i gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, do ta poziciononte Gjykatën Kushtetuese në funksionin e saj të mirfilltë kushtetues për verifikimin e rezultatit përfundimtar dhe jo për të gjitha çështjet që përfshihen në një procedurë gjyqësore.

Neni 113 i Kodit Zgjedhor të krijon përshtypjen se pavlefshmëria mund të shpallet *kryesisht* nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Shprehja e parashikuar në këtë dispozitë “*në qoftë se vëren*”, duket sikur e ka lënë në çmimin e KQZ-së konstatimin e shkeljeve që vërtetojnë pavlefshmërinë. Në të vërtetë e drejta e këtij organi, për të vendosur kryesisht për pavlefshmërinë, ekziston. Pavarësisht se neni 113 nuk parashikon shprehimisht ankimin në KQZ për pavlefshmëri nga subjektet e interesuar, e drejta e tyre për të kundërshtuar vendimet e KZZ-së ose të KZQV-së në KQZ buron nga neni 140 pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Shterimi i ankimit administrativ si një mjet mbrojtje është jo vetëm një e drejtë, por ai përbën njëkohësisht edhe një detyrim për të interesuarit, për të kërkuar më pas të drejtën e tyre në Gjykatën Kushtetuese. Ky është koncepti doktrinar i shterimit më parë të rrugëve administrative nëpërmjet rekursit administrativ, si dhe kuptimi që vetë Kodi Zgjedhor jep nëpërmjet dispozitave të sipërcituara. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka rrëzuar kërkesat e kandidatëve për deputet më arsyetimin e mungesës së legjitimitetit të tyre për shkak të mosushtrimit më parë dhe brenda afatit të caktuar në ligj të të drejtës së ankimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në vendimin nr.99/2001, Gjykata Kushtetuese arsyeton se kandidati për deputet i zonës zgjedhore nr.18 nuk i ka konsumuar mjetet e tjera ligjore të ankimit në rrugën administrative e për pasojë, në kuptim të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës dhe të neneve 113 e 140 të Kodit Zgjedhor, nuk legjitimohet. Ndërsa në vendimin nr. 107/2001, Gjykata Kushtetuese konkludon se ndaj vendimit të KQZ-së, i cili vendosi zhvillimin e zgjedhjeve

për kandidatët për deputet dhe për listat shumemërore në zonën zgjedhore nr.60, asnjë subjekt zgjedhor nuk e kishte ushtruar të drejtën ligjore të ankimit në gjykatë.

Formulimi i pikës 5 të nenit 113 të Kodit Zgjedhor, se çdo person i interesuar mund ta ankimojë vendimin e KQZ-së për t'i shpallur zgjedhjet të pavlefshme ose jo, parashikon në një paragraf të vetëm dy konceptet kryesore që lidhen me *legjitimitimin* e kërkesit për të inicuar një gjykim kushtetues dhe *juridiksionin* e Gjykatës Kushtetuese për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Në këtë dispozitë të Kodit Zgjedhor, lidhur me legjitimitimin e subjekteve që kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, përdoret formulimi “*çdo person i interesuar*”. Ky term duket mjaft i gjerë dhe përfshin në të çdo person, mjafton që ai të provojë interesin në çështjen konkrete. Megjithatë, jo çdokush dhe për çdo gjë ka të drejtë të investoj Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin gjyqësor të një akti të pavlefshëm, por vetëm ato subjekte që janë në gjendje të provojnë një interes të drejtpërdrejt dhe të ligjshëm për çështjen në shqyrtim.

Neni 66 pika 2 e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” parashikon se vetëm me kërkesë të *partisë politike* ose të *kandidatit për deputet të pavarur* mund të ushtrohet ankimi përpara Gjykatës Kushtetuese. Kjo dispozitë nënkupton se kandidati për deputet i një partie politike nuk legjitimohet, pasi kjo e drejtë i përket vetëm partisë që ai përfaqëson. Kjo mënyrë e formulimit të dispozitave të krijoj përshtypjen se midis ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe Kodit Zgjedhor ka një kontradiktë, prania e të cilës vë në diskutim ligjin që duhet zbatuar.

Praktika e ndjekur nga Gjykata Kushtetuese ka shkuar në favor të zbatimit të Kodit Zgjedhor për arsye se ai është ligji i veçantë që rregullon hollësisht procedurat që lidhen me zgjedhjet, aq më tepër që vet ligji i Gjykatës Kushtetuese për këto raste të referon në dispozitat ligjore për zgjedhjet. Gjithashtu, duke ju referuar nenit 2 të Kodit Zgjedhor rezultoi se në përkufizimin “*subjekt zgjedhor*” përfshihen krahas partive politike edhe *kandidatët e tyre*. Legjitimitimi i kandidatit për deputet për të inicuar një

gjykim kushtetues për procesin zgjedhor është i lidhur njëkohësisht dhe me të drejtën kushtetuese të shtetasve për t'u zgjedhur.

Krahas legjitimitimit të personave të interesuar trajtohet dhe afati i paraqitjes së kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese. Kodi Zgjedhor parashikon në dy nene dy afate parashkrimi. Sipas nenit 113 pika 5 *ankimi ndaj vendimit të KQZ-së, për pavlefshmërinë e zgjedhjeve ose jo, bëhet brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit të KQZ-së*. Tjetër afat ka parashikuar neni 141, sipas të cilit *vendimet e KQZ-së në lidhje me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin, si dhe për pavlefshmërinë e tyre ankimohen brenda tri ditëve nga shpallja e tyre*. Megjithëse dy dispozitat nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, në thelb ato, përsa i përket kompetencës së Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar pavlefshmërinë e vendimit të KQZ-së, marrin të njëjtin kuptim. Pavarësisht nga paqartësia që mund të ekzistojë nga pikpamja e teknikës legjislative në mënyrën e formulimit të dispozitave të sipërcituara, objekti i shqyrtimit të ankimit në Gjykatën Kushtetuese në të dy rastet nuk është i njëjtë. Pra, juridiksioni kushtetues është i ndryshëm, sepse ndërsa ankimi sipas nenit 113 ushtrohet për konstatimin e rasteve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve në zona të caktuara zgjedhore, ankimi në bazë të nenit 141 është i kufizuar vetëm ndaj vendimit të KQZ-së që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin në të gjithë territorin e Republikës.

Sipas formulimit të nenit 113 të Kodit Zgjedhor që parashikon ankimin e vendimit të KQZ *për t'i shpallur zgjedhjet të pavlefshme ose jo*, në Gjykatën Kushtetuese dy janë llojet e kërkesave që shqyrtohen për efekt të pavlefshmërisë së vendimit të KQZ-së.

Në njërin rast kërkohet pavlefshmëria e vendimit të KQZ-së që ka shpallur si të pavlefshëm zgjedhjet në qendrën e votimit, në njësitë zgjedhore ose në të gjithë territorin e Republikës. Kjo do të thotë se kërkohet pavlefshmëria e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, që në fakt sjell mosshpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme, pra vlefshmërinë e tyre. Rrëzimi i kërkesës sjell zhvillimin e zgjedhjeve në zonën përkatëse si rrjedhojë e vendimit të

KQZ-së që ka vendosur pavlefshmërinë e tyre. Kështu, KQZ-ja me vendimin nr.5, datë 1.7.2001 kishte vendosur të shpallte të pavlefshme zgjedhjet në 6 qendra votimi të zonës zgjedhore nr.4, duke urdhëruar përsëritjen e tyre. Gjykata Kushtetuese vendosi të rrëzojë kërkesën, duke lënë në fuqi vendimin e KQZ-së për pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre. Ndërsa kur pranohet kërkesa, atëherë shfuqizohet vendimi i KQZ-së që ka shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve, duke mbetur i pacenuar në këtë mënyrë rezultati i zgjedhjeve në njësinë përkatëse. Kështu, me vendimin nr.70, datë 6.7.2001, Gjykata Kushtetuese shfuqizon pjesërisht për pesë qendra votimi vendimin e KQZ-së, i cili kishte vendosur pavlefshmërinë e zgjedhjeve në 18 qendra votimi të zonës zgjedhore nr.2, duke konkluduar se në këto pesë qendra votimi zgjedhjet nuk duheshin përsëritur.

Në rastin tjetër kërkohet pavlefshmëria e vendimit të KQZ-së që ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve në njësitë përkatëse. Gjykata Kushtetuese pasi shqyrton çështjen mund të vendos rrëzimin e kërkesës, duke mos e cenuar rezultatin e zgjedhjeve ose pranimin e saj dhe shfuqizimin e aktit të pavlefshëm. Shfuqizimi i vendimit të KQZ-së sjell përsëritjen e zgjedhjeve në njësinë përkatëse pas jo më shumë se 4 javësh në kuptim të nenit 113 pika 4 të Kodit Zgjedhor etj. Kështu, duke u shfuqizuar si i pavlefshëm vendimi i KQZ-së, rrjedhimisht të gjitha vendimet e komisioneve me të ulta do të bien për arsye të pavlefshmërisë. Fakti që Gjykata Kushtetuese, pasi shfuqizon si të pavlefshëm vendimin e KQZ-së, urdhëron këtë të fundit të përsërisë zgjedhjet në njësinë përkatëse, do të thotë se të gjitha vendimet që kanë lidhje me këto zgjedhje mbeten pa fuqi juridike. Kështu, në çështjen gjyqësore që i përket zonës zgjedhore nr.13, Gjykata Kushtetuese vendosi të shfuqizojë si të pavlefshëm vendimin e KQZ-së, si dhe e detyroi këtë të fundit të përsërisë zgjedhjet në këtë zonë vetëm për kandidatët e drejtpërdrejt.

Objekt i shqyrtimit në Gjykatën Kushtetuese në çdo rast që ajo ushtron të drejtën për të verifikuar rezultatin e zgjedhjeve është pavlefshmëria e aktit. Pra, akti që kundërshtohet është vendimi i KQZ-së dhe së bashku me të edhe vendimet që kanë marrë komisionet e qendrave të votimit dhe

komisionet zgjedhore të zonave. Gjykata Kushtetuese kryen një verifikim të plotë dhe të saktë të zgjedhjeve, duke hyrë në vlefshmërinë e aktit, sepse në çdo rast ajo ka një akt për shqyrtim. Megjithatë, *pavlefshmëria e aktit nuk sjell detyrimisht edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve*. Sipas rasteve të sipërcituara mundet të shfuqizohet vendimi i KQZ-së si i pavlefshëm dhe zgjedhjet të mbeten të pacenuara. Kjo ndodh kur pas shfuqizimit të vendimit të KQZ-së, mbetet në fuqi vendimi i KZZ-së që ka shpallur deputetin fitues. Kështu, në çështjen që i përkiste zonës zgjedhore nr.33, Gjykata Kushtetuese konkludoi se gjatë procedurës së rinumërimit të votave të kryer nga gjykata e rrethit ishin konstatuar mjaftë parregullsi serioze, për të cilat KQZ-ja padrejtësisht nuk kishte mbajtur qëndrim ligjor. Në përfundim të gjykimit Gjykata Kushtetuese vendosi të shfuqizojë vendimin e KQZ-së dhe të lërë në fuqi vendimin e KZZ-së që kishte shpallur fitues kandidatin tjetër.

Në praktikën e kësaj gjykate gjenden edhe vendime që megjithëse ajo shfuqizon si të pavlefshëm vendimet e KQZ-së dhe të KZZ-së, me vendim përfundimtar detyron KQZ-në të shpall si deputet fitues kandidatin tjetër, kur krijon bindjen e plotë nga procesverbalet ose nga urdhërimi për hapjen e kutive të votimit se përsëritja e zgjedhjeve është e panevojshme. Neni 107 pika 2 e Kodit Zgjedhor ia ka njohur të drejtën Gjykatës Kushtetuese që të urdhërojë hapjen e kutive të votimit për efekt verifikimi, veprim i cili mund të sjell përmbyshjen e rezultatit të fiksuar në vendimin e KQZ-së ose të KZZ-së. Në çështjen gjyqësore që i përkiste zonës zgjedhore nr.63, Gjykata Kushtetuese urdhëroi hapjen e kutisë së votimit dhe verifikimin e procesverbalit dhe të votave që ndodheshin në të, nga ku rezultoi se pretendimi i kërkueses për pasaktësinë e procesverbalit të marrë për bazë nga komisionet zgjedhore ishte i vërtetë. Hapja e kutisë së votimit në këtë rast ndikoi drejtpërdrejt në rezultatin e zgjedhjes së kësaj zone.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në rastet kur pranojnë t'i hyjnë pavlefshmërisë së aktit që kanë për shqyrtim, mund të shprehen në dispozitiv për *rrëzimin e kërkesës* ose për *shfuqizimin e aktit*. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 132 i ka njohur Gjykatës Kushtetuese vetëm të drejtën

e shfuqizimit të aktit që shqyrton. Këto vendime datën e hyrjes në fuqi e kanë të kushtëzuar me botimin e tyre në Fletoren Zyrtare. Por duke pasur parasysh specifikën e këtyre gjykimeve që lidhen me zgjedhjet, të cilat për nga natyra e tyre janë të shpejta, në kuptim të nenit 26 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, vendimet e saj, meqenëse kanë të bëjnë edhe me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, mund të hyjnë në fuqi me shpalljen e tyre. Kjo përbën tashmë një qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Pas hyrjes në fuqi të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, fillon ekzekutimi i tyre. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Edhe vendimet që ajo merr për verifikimin e zgjedhjeve të deputetëve sigurisht që ekzekutohen. Specifika që këto vendime paraqesin i bën ato të ekzekutueshme nga organet që merren me procesin zgjedhor. Përderisa objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese bëhen vendimet e KQZ-së, atëherë është e kuptueshme se është ky organ dhe të gjitha komisionet përkatëse zgjedhore, të cilët realizojnë zbatimin e urdhërimeve që vendos Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e saj.

Pasi ka përfunduar procesi zgjedhor, gjithsecili bën një përmbledhje dhe nxjerr konkluzionet e tij për veçantitë që ai paraqiti. Duke dëshiruar të paraqes nëpërmjet kësaj trajtese ndërthurjen e koncepteve doktrinare e ligjore me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, shpresoj të kem arritur të shpreh atë, që opinioni publik nuk ka mundur ta perceptoj nga informacionet mediatike mbi seancat e pafundme gjyqësore.

E rëndësishme është të kuptohet tashmë nga të gjithë ata të cilët nuk e kanë pasur aftësinë dhe mundësinë që të dallojnë se Gjykata Kushtetuese e ka kryer veprimtarinë e saj duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Shqyrtimi me shumë kujdes i këtyre çështjeve dhe jo zvarritja e tyre, duke iu referuar dispozitave të Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor, përbën orientimin bazë të këtij institucioni kushtetues.

Aspektin më thelbësor të këtij procesi zgjedhor e përbën fakti mjaft i rëndësishëm dhe i pandodhur më parë në të tilla përmasa, që lidhet me


legalizimin e apelimeve administrative dhe gjyqësore dhe që orientoi më në fund zgjidhjen e këtyre çështjeve në rrugët institucionale. Gjykata Kushtetuese ishte organi që u tregoi subjekteve zgjedhore dhe jo vetëm atyre, se procesi zgjedhor nuk mund të jetë i pakontrollueshëm. Në këtë mënyrë është ky autoritet i lartë kushtetues, i cili nëpërmjet vendimeve thotë përfundimisht fjalën e tij në një kohë që të tjerët duhet të heshtin.

Askush tjetër përveç Gjykatës Kushtetuese nuk mund të kryejë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe askujt nuk i lind e drejta të pozicionohet në mënyrë aktive, qoftë edhe nga një funksion i caktuar publik kundër vendimeve të saj, të cilat janë përfundimtare, të formës së prerë dhe të detyrueshme për t' u zbatuar. Ky është rregulli i funksionimit të shtetit të së drejtës, për të cilin duket se ende mungon dëshira për ta mësuar lehtë. Sidoqoftë, ky proces zgjedhor krijoi precedentin dhe kjo nuk është pak.

Megjithatë dhe pavarësisht nga të gjitha këto, mbetem i sigurt, se pasi të jenë shuar natyrshëm fshikullimet emocionale ndaj procesit zgjedhor dhe kontrollit verifikues institucional mbi të, nga të gjithë aktorët politik vendas, si dhe pasi të jenë lexuar dhe kuptuar drejt arsyetimet ligjore e kushtetuese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, zgjidhjet e të cilave janë rrjedhojë dhe e aftësisë ose paaftësisë së mbrojtjes ligjore të palëve në proces, kuptohet se edhe qëndrimet do të jenë më të kujdesshme.

Procesi zgjedhor në Shqipëri: Ligj dhe praktikë e re

*Sokol Lamaj
Drejtore i Drejtorisë Juridike
në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve*



Tashmë pas një periudhe thujse 10-vjeçare zgjedhjesh demokratike në vend, kushdo është i ndërgjegjshëm se themeli dhe baza e ndërtimit të një shteti demokratik, i cili respekton dhe garanton votën e popullit, janë zgjedhjet e lira, të ndershme dhe të barabarta për të gjithë. Kushtetuta e Shqipërisë, e cila u miratua nga referendumi popullor, parashikon në një pjesë të veçantë të saj ngritjen, funksionimin dhe detyrat e një institucioni të ri. Ky është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në zbatim të kësaj pjese të Kushtetutës, Kuvendi i Shqipërisë më 8.5.2001 miratoi Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Ky ligj i ri parashikon futjen e një sërë normash dhe praktikash të reja, të panjohura dhe të pazbatuara më parë nga komisionet zgjedhore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve garanton të drejtën kushtetuese të votës së lirë, në mënyrë të tillë që çdo zgjedhës të ketë mundësi për t'u shprehur për alternativën që dëshiron, nëpërmjet votës së tij.

Ja një vështrim i shkurtër në lidhje me procesin zgjedhor të realizuar në zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

LISTAT E ZGJEDHËSVE:

Një nga elementet më të rëndësishëm për procesin zgjedhor është hartimi i listave të zgjedhësve dhe rregullimi i infrastrukturës zgjedhore. Nga praktika e deritanishme, e cila u vlerësua dhe u konsiderua si një përvojë dhe trashëgimi e ardhur nga praktikat e mëparshme zgjedhore, ky element ishte tepër i ndjeshëm për partitë politike dhe subjektet që morën pjesë në këto zgjedhje, por njëkohësisht edhe për bashkësinë ndërkombëtare që u paraqit si një element tepër i rëndësishëm në proces nëpërmjet mendimeve e sugjerimeve të herëpashershme, po edhe nëpërmjet ofrimit të konsulencës dhe asistencës teknike në lidhje me hartimin e këtyre listave. Hartimi i tyre synonte në verifikimin, pasurimin dhe saktësimin e listave të zgjedhësve me anë të regjistrave të gjendjes civile. Në këtë proces u përfshinë një numër i madh punonjësish të gjendjes civile pranë organeve të pushtetit vendor, si dhe të komisioneve të zgjedhjeve të qeverisjes vendore, të cilat e kryenin këtë detyrë sipas parashikimit që bën vetë Kodi Zgjedhor. Me gjithë angazhimin që patën këto struktura, vetë infrastruktura ligjore dhe ajo që ofronin zyrat e gjendjes civile, linin mjaft për të dëshëruar, duke sjellë si pasojë që një punë e madhe e voluminoze të kryhej nëpërmjet grupit tresh të verifikimit derë më derë, çka solli vështirësi edhe në procesin vendimmarrës të këtyre komisioneve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me synimin e tij ligjor për krijimin e një Regjistri Kombëtar të Votuesve të saktë, programoi rishikimin e listave të zgjedhësve. Kjo veprimtari u planifikua të kryhej për 35 ditë, nga data 25.5.2001 deri më 1.6.2001. Për mbarëvajtjen dhe organizimin e këtij procesi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxori edhe një sërë udhëzimesh, të cilat e shtrinin juridiksionin e tyre në të gjithë vendin. Por shumë shpejt u vërejt se si KZZ-ët, ashtu edhe KZQV-të përbëheshin kryesisht nga njerëz të cilët drejtoheshin dhe dominoheshin nga vullnete dhe forca politike që i kishin propozuar. Këta nuk ishin profesionistë të trajnuar, po militantë ose “të fortë”, të cilët e bënë procesin vendimmarrës në shumë raste të vështirë dhe problematik.

KOMISIONET:

Një problem i veçantë gjatë procesit zgjedhor ka qënë edhe ndërtimi i komisioneve të zonave zgjedhore (KZZ-ve). Kodi Zgjedhor në nenin 32 parashikon mënyrën dhe formën e ndërtimit të KZZ-ve. Në pikën 1 të këtij neni është përcaktuar se KZZ-ja përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe deri në pesë anëtarë të emëruar nga KQZ-ja, me propozimin e shtatë partive politike që kanë fituar më shumë vota në zonën përkatëse në zgjedhjet e fundit për Kuvendin. Gjatë procesit të ndërtimit të këtyre komisioneve u vërejt se Kodi kishte një zbrazëti për rastet kur në zgjedhje kishin marrë pjesë dy ose më shumë parti së bashku, në formën e koalicionit. Sipas Kodit Zgjedhor, kuptimi i koalicionit përmbahet vetëm në të drejtën e dy ose më shumë partive politike të regjistruara në KQZ, të cilat paraqesin një listë shumemërore të përbashkët për zgjedhjet për Kuvendin. Në këto kushte disa parti, të cilat hynë në zgjedhje si koalicion, u detyruan, që si pjesë të marrëveshjes së tyre, të përcaktonin edhe mënyrën e ndarjes së vendeve brendapërbrenda koalicionit, në mënyrë që në zgjedhjet e ardhshme të mos paraqiteshin probleme në krijimin e tyre.

Një debat i tillë u bë objekt shqyrtimi edhe nga sistemi gjyqësor, i cili nuk mundi të jepte një version përfundimtar në lidhje me këtë problem, duke e lënë zgjidhjen e saj në kompetencën e KQZ-së dhe të vetë subjekteve politike pjesëmarrëse në këto zgjedhje. Një element i tillë gjeneroi një novacion në lidhje me zbatimin e saj në praktikë në kuptimin e Kodit Zgjedhor, i cili në ndryshim me ligjet zgjedhore të zbatuara më parë në Shqipëri, paraqet një rregullim të marrëdhënieve juridike të reja.

POLITIZIMI I KOMISIONEVE

Një kontradiktë themelore që u vërejt gjatë procesit zgjedhor, ishte edhe mënyra dhe ndërtimi i komisioneve të zonave zgjedhore. Vetë Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor e kanë parashikuar dhe ndërtuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si një komision teknik, të paanshëm dhe larg ndikimeve politike. Një gjë të tillë e tregon edhe vetë prejardhja e anëtarëve të tij, nga ku, tre

anëtarë emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dy anëtarë nga Presidenti i Republikës dhe dy të tjerë nga Kuvendi i Shqipërisë. Në kontradiktë me këtë formim të KQZ-së është ndërtimi i KZZ-ve, të cilat Kodi Zgjedhor i ka parashikuar të emërohen nga KQZ-ja me propozimin e shtatë partive politike që kanë më shumë vota në zonën zgjedhore përkatëse në zgjedhjet e fundit për Kuvendin. Vetë procesi vërtetoi se anëtarët e këtyre komisioneve, në shumë raste udhëhiqeshin nga interesa të ngushtë partiakë e politikë të partive të cilat i kishin propozuar, duke mos dashur të zbatojnë procedurat ligjore e nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pati shumë raste, ku një pjesë e shumicës së anëtarëve të këtyre komisioneve braktisën detyrën ose, duke iu bindur interesave politikë, nuk kryenin detyrimet që u ngarkonte ligji, duke sjellë si pasojë në disa raste edhe bllokimin e procesit zgjedhor. Por kur themi “bllokim të procesit zgjedhor”, duhet të kuptojmë se në atë zonë zgjedhore një numër i caktuar zgjedhësish kanë votuar dhe kanë shprehur të drejtën e tyre kushtetuese “për të zgjedhur”. Tashmë është e qartë se ngritja, funksionimi dhe organizimi i punës së këtyre komisioneve kërkon një rregullim ligjor të qartë dhe të saktë në Kodin Zgjedhor. Ndoshta vetë klasa politike aktuale, ndryshe nga mendësia që ekzistonte më parë, mund ta ketë kuptuar dhe duhet të ndërgjegjësohet se organizimi i zgjedhjeve në vend, ashtu si edhe në shumë vende të tjera me demokraci të zhvilluar, duhet të bëhet nga komisione teknike, të paanshme, larg interesave politike e partiake. Duke qenë se jemi në një shoqëri tejet të politizuar dhe me një varfëri të madhe, është e domosdoshme që vota të ruhet e të administrohet nga komisione të specializuara, të trajnuara e të praktikuara, duke krijuar një administratë zgjedhore kompakte dhe profesionale.

TË PAVARURIT:

Elementi që zotëroi më shumë diskutimet e subjekteve politike gjatë procesit zgjedhor, duke rrezikuar ndonjëherë edhe zhvillimin e tij, ishte problemi i kandidimit për zgjedhjet për Kuvend të “kandidatëve të pavarur”. Në çdo proces zgjedhor për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor, e për

më tepër për zgjedhjet për Kuvendin, partitë politike marrin pjesë në to me kandidaturat më të mira, duke treguar vlerat e tyre me qëllimin për të marrë sa më shumë vende në këto organe vendimmarrëse. Zgjedhjet për Kuvendin janë zgjedhjet më të rëndësishme politike, pasi ky organ përcakton edhe drejtimet kryesore të zhvillimit dhe politikës në vend, si dhe është organi më i lartë vendimmarrës.

Ndryshe nga çdo përvojë botërore, por edhe nga ato të viteve të kaluara te ne, partitë më të mëdha politike nuk vendosën kandidatë në shumë zona zgjedhore për kandidatë të drejtpërdrejtë, duke mbështetur hapur “kandidatët e pavarur”. Një element i tillë buron nga rregullimi që bën Kodi Zgjedhor për rregullat e ndarjes së mandateve plotësuese. Kodi Zgjedhor në nenin 66, në zbatim të nenit 64 të Kushtetutës, ka përcaktuar rregullin dhe procedurën e përlllogaritjes dhe të shpërndarjes së mandateve plotësuese. Nga zbatimi i drejtë i këtij neni, ku partitë ose koalicionet politike marrin pjesë me kandidatë të drejtpërdrejtë në zonat njëemërore, në rastin e kalimit të një numri limit të caktuar këto parti ose koalicione politike nuk përfitojnë asnjë mandat nga ndarja e mandateve plotësuese. Duke dashur që mundësia për të përfitur nga ndarja e këtyre mandateve të ishte sa më e lartë duke rritur numrin e deputetëve të një partie në mënyrë krijimin e një shumice të cilësuar, partitë ose koalicionet politike dolën në mbështetje të kandidatëve të pavarur, që nuk ishin gjë tjetër veçse kandidatë të vetë këtyre partive ose koalicioneve politike. Është për t’u vërejtur se një gjë e tillë ishte karakteristike për partitë e mëdha dhe kundërshtojë nga partitë e vogla, të cilat përfitonin nga ndarja e këtyre mandateve plotësuese. Në këto kushte, kur vetë vullneti politik nuk ishte në gjendje të dilte nga impasi i krijuar dhe kur institucioni i Kuvendit ishte i shpërndarë, ndërhyrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ishte e domosdoshme dhe vendimtare në përcaktimin e mbështetjes që kandidatët e pavarur merrnin nga partitë ose koalicionet e partive politike.

NXJERRJA E AKTEVE NORMATIVE

Nga një vështrim i praktikës së deritanishme të zgjedhjeve për Kuvendin për vitin 2001 u vërejt se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhor, ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm vendimesh dhe udhëzimesh me karakter të përgjithshëm. Pra, vendime dhe udhëzime me karakter normativ për rregullimin e marrëdhënieve juridike, të cilat lidhen me një proces zgjedhor sa më korrekt, ligjor dhe të barabartë. Ushtrimi i një kompetence të tillë ka bërë që në disa raste, siç mund të përmendim përcaktimin e kandidatëve të pavarur, procedurat e matrikullimit të zgjedhësve etj., Komisioni Qendror të përcaktojë rregulla dhe procedura të cilat nuk gjejnë rregullim në Kodin Zgjedhor.

POZITA E KQZ-SË NË PIRAMIDËN E ADMINISTRATËS.

Kodi Zgjedhor në nenin 18 ka parashikuar një sërë kompetencash për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ndër kompetencat më të rëndësishme që ka ai mund të përmendim nxjerrjen, në zbatim të ligjit dhe brenda sferës së juridiksionit të tij, të vendimeve dhe udhëzimeve me fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës, marrjen e vendimeve për njehësimin e praktikave zgjedhore, drejtimin dhe kontrollin e procesit parazgjedhor dhe atë zgjedhor, shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve në shkallë vendi në bazë të rezultateve të shpallura nga KZZ-ja ose sipas rastit nga KZQV-ja, administrimin e procesit të regjistrimit të zgjedhësve etj.

Një problem i diskutuar dhe i paraqitur edhe gjatë procesit zgjedhor është pozita dhe vendi që zë KQZ-ja, krahasuar me institucionet e tjera kushtetuese dhe me institucionet e tjera të administratës shtetërore. Subjekte të ndryshme e kanë konsideruar KQZ-në si një institucion jashtë administratës publike dhe jashtë rregullave të saj. Po t'i referohemi parimeve të përgjithshme të së drejtës kushtetuese, sot njihen tri pushtete, në të gjitha format e strukturës dhe të ndërtimit të shteteve, pavarësisht nga llojet e sistemeve. KQZ-ja nuk është as pjesë e pushtetit parlamentar dhe as pjesë e

pushtetit gjyqësor, por përafrohet dhe kryhen funksionet e saj si pushtet ekzekutiv, por me një pozitë dhe rregullim të posaçëm kushtetues e ligjor.


PËRFUNDIM

Me gjithë mangësitë e vërejuara, në përgjithësi fushata zgjedhore dhe procesi zgjedhor u paraqit i qetë. Për herë të parë u zbatuan dispozitat e rregullat e vendosura nga Kodi Zgjedhor. Këto ishin një hap përpara në përafrimin e procesit zgjedhor me ato të standardeve të zbatuara në vendet me demokraci të zhvilluar, duke bërë që gradualisht klasa politike të ecë drejt ndërgjegjësimit për një proces të rregullt ligjor, larg interesave të ngushta politike.

Pas një përvoje dhe përpjekjes për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për proceset zgjedhore në Shqipëri, mendoj se rishikimi dhe ridimensionimi i Kodit Zgjedhor, në kërkim të një garantimi sa më të madh të votës së lirë dhe të së drejtës kushtetuese për të zgjedhur, tashmë është një domosdoshmëri. Këto ndryshime duhet të konsistojnë në dhënien e kompetencave më të mëdha Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me administrimin e procesit zgjedhor, me verifikimin e gjendjes së faktit të kutive të votimit, me zgjidhjen e konflikteve të subjekteve të interesuara gjatë procesit zgjedhor etj., të cilat do të çojnë në uljen e konflikteve gjyqësore, për krijimin e komisioneve të zonave jopartiake, teknike e profesioniste të cilat të garantojnë dhe pasqyrojnë profesionalizëm dhe nivel të lartë e të shpejtë vendimmarrje, për përcaktimin e procedurave zgjedhore, për kryerjen e zgjedhjeve në të gjithë vendin, në të njëjtën kohë, në mënyrë që të garantohet paanshmëria dhe barazia e votës për të gjithë zgjedhësit.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Legjislacioni i Brendshëm

Prof. Arben Puto



Është tanimë i njohur përgjithësisht parimi sipas të cilit Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut qëndron mbi ligjin e brendshëm. Një shtet palë nuk mund t'u shmanget detyrimeve të tij që rrjedhin nga Konventa, duke sjellë si argument të drejtën e tij të brendshme. Çdo shtet vendos, në përgjithësi, deri në ç'masë dhe në ç'mënyrë e drejta e tij e brendshme do të përcaktojë rregullat për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa. Kjo, si edhe normat e tjera të së drejtës ndërkombëtare kërkojnë nga palët që të plotësojnë konkretisht detyrimet, por ua lenë shteteve palë të përcaktojnë mënyrën se si do t'i plotësojnë këto detyrime.

Raporti midis së drejtës ndërkombëtare dhe së drejtës së brendshme nuk është i ri. Ai është zgjidhur në mënyra të ndryshme në shtete të ndryshme. E drejta ndërkombëtare mund të jetë në radhën e së drejtës së brendshme kushtetuese, madje edhe më lart ose mund të ketë një pozicion të ndërmjetëm midis së drejtës kushtetuese dhe akteve ligjore, ose mund të mos ketë vlefshmëri ligjore të drejtpërdrejtë në të drejtën e brendshme. Të gjitha këto zgjidhje janë njohur si të pajtueshme me parimet e së drejtës ndërkombëtare për aq sa rendi ligjor i brendshëm garanton detyrimet ndërkombëtare.

Çështja e pozicionit të Konventës kundrejt së drejtës së brendshme trajtohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konventa nuk është përfshirë si e tillë në Kushtetutë. Si shembull, lidhur me këtë përmendet vetëm Austria. Në rastin tonë çështja zgjidhet në kuadrin e lidhjes së traktateve ndërkombëtare. Ajo përfshihet në kreun II të pjesës së shtatë dhe konkretisht në nenin 122. Për një sqarim të plotë ia vlen të jepen dispozitat kryesore të dy paragrafeve. Paragrafi 1 thotë: “Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...”. Paragrafi 2 thotë: “Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”.

Nga sa më sipër mund të gjykohet edhe mbi raportin midis Konventës dhe të drejtës së brendshme shqiptare. Konventa mund të vihet edhe në radhën e akteve ligjore të zakonshme si pjesë përbërëse e sistemit të brendshëm juridik të vendit. Por Konventa, në bazë të paragrafit 2, mund të vihet mbi aktet ligjore. Pas ratifikimit të saj në 1995, Konventa ka epërsi mbi ligjet e vendit, kur këto ligje nuk pajtohen me të. Për pasojë Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut zë një vend të dorës së parë në legjislacionin shqiptar. Por çështja e raportit midis së drejtës së brendshme dhe të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ka disa veçori. Çështja shtrohet konkretisht për Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Konventa është e lidhur me disa probleme të veçanta. Para së gjithash, ndryshe nga traktatet e tjera, Konventa ka për qëllim të mbrojë individin nga veprime të padrejta të autoriteteve të shtetit të vet. Së dyti, Konventa ndërhyt në rendin e brendshëm ligjor, duke kërkuar, për shembull, adoptimin e një ligji të domosdoshëm në një shoqëri demokratike për plotësimin e një të drejte që garantohet nga Konventa. Së treti, Konventa ka krijuar organet e saj, veçanërisht Gjykatën, për të mbikëqyrur plotësimin e dispozitave të saj nga autoritetet kombëtare. Ajo parashikon po ashtu peticionet individuale

drejtuar Gjykatës, duke rrëzuar kështu barierën e zakonshme që ekziston midis një personi të veçantë dhe së drejtës ndërkombëtare. Vendimet që merren në bazë të Konventës nga organet e saj shpesh u kërkojnë shteteve palë të bëjnë ndryshime përkatëse në të drejtën e tyre të brendshme, në mënyrë që ato të përputhen me dispozitat e Konventës.

Një çështje me rëndësi është ajo që ka të bëjë me pozicionin e së drejtës së brendshme ndaj organeve të Konventës. Kuptohet se e drejta e brendshme luan një rol në procedurat dhe marrjen e vendimeve nga organet e Konventës, në rastin konkret nga Gjykata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut.

Në shumë raste nuk është e qartë nëse e drejta e brendshme është në përputhje me Konventën. Gjykata, nga ana e saj, e ka theksuar më se njëherë se ajo shqyrton çështje konkrete dhe nuk mund të trajtojë çështje ligjore në një plan të përgjithshëm. Por kjo nuk do të thotë se rëndësi ka vetëm zbatimi i një rasti të veçantë nga e drejta e brendshme. Është po ashtu me rëndësi edhe përputhja e vetë ligjit me Konventën. Dhe ndodh shpesh që pajtueshmëria e ligjit me Konventën shtrohet si një çështje qendrore. Kjo ndodh kur zbatimi i ligjit çon në mënyrë të pashmangshme në një shkelje të Konventës. Edhe në qoftë se ky ligj nuk është zbatuar ende, vetë fakti i ekzistencës së tij është shkelje e Konventës. Në të vërtetë, ka pasur disa raste kur organet e Konventës kanë konkluduar se ligje të brendshme - zakonisht disa dispozita të veçanta të tyre - çojnë në shkeljen e Konventës. Por kur Gjykata Ndërkombëtare vjen në përfundimin se një ligj i caktuar është në mospërputhje me Konventën, vendimi i saj e quan shtetin përkatës se ka shkelur detyrimet e tij në bazë të Konventës. Gjykata nuk mund ta deklarojë këtë ligj si të pavlefshëm ose të pazbatueshëm. Në parim, në të drejtën ndërkombëtare një gjykatë ndërkombëtare nuk është kompetente të shpallë ligjin përkatës si të pavlefshëm. Ajo nuk e detyron drejtpërdrejt shtetin përkatës që ta ndryshojë ligjin. Kjo rrjedh nga fakti se ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Europiane nuk është në duart e saj. Mbikëqyrja e

ekzekutimit të këtyre vendimeve i besohet Komitetit të Ministrave, organ i Këshillit të Europës, në bazë të nenit 46 paragrafi 2, i cili thotë se “vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave i cili mbikqyr zbatimin e tij”.

Një rast i veçantë është edhe kur nuk ekzistojnë dispozita ligjore të brendshme. Edhe kjo mund të çojë në shkelje të Konventës. Kjo ka të bëjë veçanërisht me kufizimet e disa të drejtave të parashikuara nga nenet 8 deri 11 të Konventës. Këto kufizime duhet të përcaktohen me ligj. Kur për këto kufizime nuk ka dispozita ligjore, atëherë kemi shkelje të Konventës. Këtu del përsëri lidhja e ngushtë që ekziston midis së drejtës së brendshme dhe Konventës: e drejta e brendshme duhet t’u përshtatet standardeve europiane të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Për këtë ka një nen të veçantë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 17. Në paragrafin e tij të parë ai merr po atë formulim që është bërë edhe në Konventën Europiane. Kurse në paragrafin e tij të dytë ai i referohet drejtpërdrejt Konventës kur thotë: “Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Lidhur me kufizimet që parashikojnë nenet 8 deri 11 të Konventës, shteteve u lihet një marzh vlerësimi. Fjala është konkretisht për nenin 15 të Konventës. Në paragrafin 1 të këtij neni lexojmë: “Në rast lufte ose në rast të një rreziku tjetër publik që kërcënon jetën e kombit, çdo palë e lartë kontraktuese mund të marrë masa që u shmangen detyrimeve të parashikuara nga kjo Konventë, por vetëm për aq sa e kërkon situata dhe me kusht që këto masa të mos jenë në kundërshtim me detyrimet e tjera që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare”. Është e qartë se këto kufizime përcaktohen nga autoritetet kombëtare dhe në këtë kuptim atyre u lihet një marzh veprimi, duke vendosur ato masa që i përgjigjen situatës së krijuar. Nga ana e tyre, institucionet europiane kanë për detyrë të mbikëqyrin nëse këto masa mund të jenë në përputhje me Konventën. Mund të vërehet se një shtet e ka shkelur Konventën vetëm kur shteti i ka kapërcyer limitet e Konventës. Me një

fjalë, shtetet nganjëherë kanë mundësi të zgjedhin kur u vënë kufizime të drejtave të njeriut dhe këto zgjedhje në të drejtën dhe praktikën e brendshme janë në pajtim me Konventën. Institucionet e Strasburgut në raste të tilla nuk vendosin nëse kjo apo ajo masë që është marrë është më e mira ose më e përshtatshme, mjafton që ato të jenë të pajtueshme me Konventën. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në raste të tilla nuk del si gjykatë kasacioni, ajo mund të konsiderohet më shumë si një gjykatë kushtetuese kombëtare, e cila i lë po ashtu një marzh veprimi ligjvënësit për të nxjerrë ligje në përputhje me Kushtetutën e shtetit.

* * *

Një kusht i domosdoshëm për marrjen në shqyrtim të kërkesave individuale nga ana e Gjykatës është ai që quhet “shterrimi i mjeteve të brendshme”. Kjo do të thotë se çështja duhet të ketë kaluar të gjitha procedurat përpara organeve të brendshme të shtetit, pastaj mund të merret në shqyrtim nga Gjykata. Kjo është parashikuar nga neni 35 i Konventës në paragrafin 1 të të cilit lexojmë: “Gjykata nuk mund të vihet në lëvizje përveçse kur janë shteruar mjetet e brendshme ligjore, ashtu siç kuptohen sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar dhe brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e vendimit të brendshëm përfundimtar”.

Kjo dispozitë nxjerr në pah fare qartë marrëdhëniet e ndërsjella midis institucioneve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare. Nuk është e rastit që, kur flitet për shterrimin e mjeteve të brendshme, theksohet se ato duhet t’u përgjigjen “parimeve të së drejtës ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar”.

Mund të ndodhë që një shtet mund të krijojë organe dhe organizma me qëllim që të dalë me pretendimin se nuk janë shteruar të gjitha mjetet e brendshme. Në të vërtetë, ka ndodhur nganjëherë që shtetet u janë referuar mjeteve vendore, të cilat nuk kanë asnjë rëndësi praktike ose nuk janë njohur nga ekspertë të fushës, si dhe nga gjykatat e brendshme. Institucionet europiane kanë për detyrë ta hetojnë çështjen dhe të vendosin se cilat janë

mjetet që njihen realisht në të drejtën e brendshme. Kjo detyrë u lehtësohet deri diku atyre nga që shteti përkatës ka detyrimin që të japë shpjegime për të drejtën e tij të brendshme dhe të tregojë se mjetet e përmendura prej tij janë në fakt efektive dhe të zbatueshme në praktikën e tij. Kur nuk jepen këto shpjegime, del përfundimi se mjetet e brendshme duhet të jenë në pajtim me parimet e përgjithshme të së drejtës dhe se ato që nuk u përgjigjen këtyre parimeve nuk mund të futen në shterrimin e këtyre mjeteve.

Janë edhe disa çështje të tjera që meritojnë vëmendje.

Së pari, del nevoja e interpretimit të Konventës. Lidhur me këtë nuk mund të injorohet fakti se parimet që përmbahen në një pjesë të sistemit ligjor ose në gjithë rendin juridik të shteteve anëtare të Konventës merren parasysh kur del nevoja e interpretimit të Konventës, madje këto parime janë një faktor me peshë në këtë çështje. Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, që është një organ që vepron në kuadrin e OKB-së, thotë se kjo Gjykatë duhet të zbatojë parimet e përgjithshme të së drejtës dhe e njëjta gjë duhet të bëhet nga institucionet që kanë përgjegjësinë e interpretimit të Konventës Europiane.

Parimet e përgjithshme të së drejtës që përmban e drejta e brendshme e shteteve anëtare të Këshillit të Europës janë edhe më me rëndësi për interpretimin e Konventës. Kjo për arsye sepse Këshilli i Europës përfshin një grup më homogjen shtetesh sesa bashkësia ndërkombëtare në tërësi; veç asaj, Konventa synon të arrijë standarde të përbashkëta europiane në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut brenda kufijve të shteteve anëtare. Në të vërtetë, në përbërjen e Gjykatës Ndërkombëtare ka juristë të kualifikuar dhe çdo anëtar caktohet nga secili shtet anëtar i Konventës. Ky fakt sjell përvoja të ndryshme dhe një njohje më të mirë të së drejtës së shteteve anëtare, gjë që ka peshën e vet kur ajo shqyrton një çështje dhe merr vendim. Si përfundim, përsa i përket interpretimit të Konventës, ky interpretim nuk mund të jetë në kundërshtim me normat dhe parimet që ndeshen më së

shumti në shtetet anëtare, por nuk mund të varet as nga unanimiteti midis shteteve anëtare.

Çështja e dytë ka të bëjë me efektet që kanë vendimet e Gjykatës në të drejtën e brendshme. Këto efekte mund të ndryshojnë sipas përmbajtjes së gjykimit. Në qoftë se Gjykata e quan një ligj të papajtueshëm me Konventën, ligji duhet të ndryshohet ose të abrogohet. Në qoftë se një proces penal përpara një gjykate kombëtare është zhvilluar në kundërshtim me Konventën, mund të jetë e domosdoshme që gjykimi i dhënë të anulohet dhe të rihapet procesi penal.

Në qoftë se Gjykata Europiane ka vendosur se një shtet ka shkelur Konventën, shteti në fjalë është i detyruar që të rikthejë personin e interesuar në të drejtën që ai ka pasur ose mund të kishte në qoftë se nuk do të shkelej Konventa. Rikthimi tërësor (*restitutio in integrum*) varet nga rrethanat konkrete dhe rikthimi mund të bëhet për aq sa është e mundshme. Rikthimi mund të jetë edhe i pamundur për arsye objektive dhe ligjore. Në qoftë se një objekt pronësie është marrë ose është kufizuar duke cenuar Konventën, ose në qoftë se një paraburgim ose burgim nuk justifikohet në bazë të Konventës, dhe është i paligjshëm sipas saj, shteti përkatës është i detyruar ta ndreqë situatën. Në këtë rast rikthimi tërësor (*restitutio in integrum*) është zgjidhja më e përshtatshme.

Kur Gjykata vëren se një shtet ka shkelur Konventën dhe situata vazhdon të jetë po ajo edhe pas gjykimit (p.sh. një burgim i paligjshëm), shteti në fjalë duhet t'i japë fund shkeljes pa vonesë. Në qoftë se rikthimi është i pamundur në tërësi ose pjesërisht, individit i interesuar mund të marrë kompensim që të shmangë pasojat e shkeljes së Konventës. Por përsëri në atë masë që është e mundur.

Në vijim të sa më sipër, shtrohet çështja e mënyrave të zbatimit të vendimeve të Gjykatës ndërkombëtare në të drejtën e brendshme. Disa shtete parashikojnë që këto vendime të zbatohen drejtpërdrejt në të drejtën e brendshme. Disa shtete të tjera kanë adoptuar dispozita që u lejojnë atyre të rishikojnë vendime të brendshme që kanë rezultuar në mospërputhje me

Konventën. Mund të mendohet se gjithnjë e më shumë shtete do të adoptojnë dispozita të qarta ligjore në të drejtën e brendshme, të tilla që mund t'i bëjnë gjykimet e Strasburgut të zbatueshme në rendin ligjor të brendshëm. Por janë shprehur dyshime lidhur me faktin nëse shtetet anëtare janë të detyruara ta bëjnë një gjë të tillë. Edhe këtu ka një marzh veprimi. Shtetet kanë detyrimin që të arrijnë një rezultat, i cili të jetë në pajtim me detyrimet që rrjedhin prej Konventës. Por është e drejtë e tyre që të zgjedhin mënyrën se si do ta bëjnë këtë.

Duke përfunduar mund të thuhet se midis Konventës Europiane dhe të drejtës së brendshme ka një lidhje të ngushtë, e cila shprehet: në drejtim të zbatimit të normave (duke zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës), në drejtim të shterimit të mjeteve të brendshme, të interpretimit të normave, të efekteve të zbatimit të Konventës në të drejtën e brendshme, të mënyrave të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Europiane në të drejtën e brendshme. Në këtë lidhje gjen shprehje në përgjithësi raporti midis Konventës dhe të drejtës së brendshme. Kemi të bëjmë me dy rinde ligjore në marrëdhënie midis tyre. Por duhet pohuar se Konventa përfaqëson një rend juridik epror në fushën e të drejtave të njeriut, përderisa shtetet i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës Europiane në këtë sferë të veçantë.

Kërkesa e Kushtetutës rreth “Procesit të rregullt ligjor”

*(Parë nëpërmjet shqyrtimit të vendimeve
të Gjykatës Kushtetuese)*

*Alfred Karamuço
Anëtar i Gjykatës Kushtetuese*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në paragrafin e parë të nenit 42 ka sanksionuar se “Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të çënohen pa një proces të rregullt ligjor.”

Trajtimi i posaçëm i kësaj dispozite në një punim të veçantë, diktohet në radhë të parë nga fakti, se e drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë vetjake e rëndësishme. Nga ana tjetër, ajo lidhet me një ndër kompetencat që ka Gjykata Kushtetuese në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Kështu, në nenin 131 të Kushtetutës parashikohet edhe “grykimi përfundimtar i ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juiridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave”. Së treti, shqyrtimi i këtyre dispozitave mendoj se mund t’i shërbejë edhe mënjanimi të keqkuptime të vëna re në veprimtarinë e ndonjë organi për kuptimin e zbatimin e tyre e sidomos të lidhura ngushtë me kontrollin kushtetues që bën Gjykata Kushtetuese.

Konceptin “proces të rregullt të lidhur me mbrojtjen e të drejtave të individit e gjejmë të shprehur për herë të parë në Magna Charta e Enrikut

III që mban datën 11 shkurt 1225, në një nga dispozitat e së cilës parashikohet se asnjë njeri i lirë nuk mund të arrestohet, burgoset, të largohet nga prona etj., ... të nxirret jashtë ligjit, në qoftë se kjo s' bëhet në zbatim të një gjykimi legal e sipas ligjit të vendit. Këtë koncept e gjejmë edhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Shtetit të Virxhinias më 1776, si dhe në Amendamentet 5 dhe 14 të Kushtetutës Amerikane të vitit 1787. Kështu, në Amendamentin 14 paragrafi i parë i Kushtetutës Amerikane sanksionohet se “Asnjë prej shteteve nuk mund të privojë asnjë person nga jeta, liria ose pasuria pa një proces të rregullt gjyqësor ose t’i mohojë çfarëdo personi nën juridiksionin e vet të drejtën për t’u mbrojtur njëlloj nga ligjet”. Më pas, në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarëve të vitit 1789, gjejmë konceptin “proces i drejtë”, koncept, i cili më vonë zuri vend edhe në nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e OKB-së më 10 dhjetor 1948.

Më tej, duke iu referuar dokumenteve më të reja, në Konventën Europjane të të Drejtave të Njeriut, në nenin 6, zë vend koncepti “proces equitabël”, i përkthyer jo në mënyrë të saktë si “proces i rregullt”. Ndryshe nga konceptet e mëparshme, “procesi equitabël” sipas Konventës parashikon jo vetëm procesin penal, por edhe atë me karakter civil. Nga ana tjetër, duke iu referuar tekstit të Konventës, ky koncept presupozon njëherësh një proces të drejtë, publik, të kryer në afat të arsyeshem, nga një gjykatë e krijuar ligjërisht, e pavarur dhe e paanshme.

Në dhjetëveçarin e fundit, konceptet kushtetuese “proces i rregullt” dhe “proces i drejtë” zunë vend edhe te ne në dispozitat kushtetuese. Në ligjin kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, në nenin 38 është sanksionuar se “Liria, prona ose të drejta të pranuar me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”. Kushtetuta e re, në nenin 42 paragrafi 1 (që u citua më sipër) ka pak a shumë të njëjtin formulim. Ndryshimi i vetëm ka të bëjë me atë, se objekt nuk janë vetëm të drejtat e pranuar me ligj, por në radhë të parë ato të njohura në Kushtetutë, si dhe në ligj.

Në dallim me aktet ndërkombëtare të cituara më lart, të cilat shprehimisht ose në formë të tërthortë bëjnë fjalë për “proces gjyqësor”, në Kushtetutën tonë ka gjetur vend koncepti “proces i rregullt ligjor”. Në Gjykatën Kushtetuese ka zënë vend mendimi (i drejtë), sipas të cilit procesi ligjor nuk ka të bëjë vetëm me atë gjyqësor (civil ose penal), por edhe me procesin administrativ, sepse edhe nëpërmjet një procesi administrativ të parregullt mund të cenohen liria, prona ose të drejta të tjera të individit.

Në nenin 42 të Kushtetutës sonë gjenden dy koncepte lidhur me garancitë e qytetarëve në mbrojtje të lirisë, pronës ose të të drejtave të njohura me Kushtetutë dhe me ligj: “proces i rregullt” (paragrafi i parë) dhe “gjykim i drejtë” (paragrafi i dytë). Midis dy paragrafëve ndryshimet janë të dukshme. Ndërsa në paragrafin e parë fjala është si për proces gjyqësor, ashtu dhe për atë administrativ, në paragrafin e dytë bëhet fjalë vetëm për proces gjyqësor (penal ose civil). Po kështu, ndërsa paragrafi i dytë i ka të detajuara garancitë në gjykim (të drejtë, publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e caktuar me ligj), në paragrafin e parë nuk gjen shpjegim koncepti “proces i rregullt ligjor”. Megjithatë, nga shqyrtimi i kësaj dispozite del se edhe pse paragrafi i parë bën fjalë për “proces të rregullt ligjor”, elemente të procesit të rregullt gjenden edhe në paragrafin e dytë dhe sidomos te gjykimi publik i paanshëm, nga një gjykatë e pavarur etj. Kështu, për shembull, janë një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese ku është konsideruar proces i parregullt procesi gjyqësor ku paanshmëria e gjykatës është cenuar. Me këto dua të nënvizoj se nuk ka një ndarje me thikë midis kuptimit e zbatimit të të dy paragrafëve të nenit 42 dhe se në praktikë elemente të “procesit të rregullt” janë gjetur në referim të parimeve themelore procesuale të përcaktuara si në paragrafin e parë e të dytë të nenit 42, ashtu dhe në dispozita të tjera kushtetuese e procedurale. Meqenëse pikërisht paragrafi i parë i kësaj dispozite lidhet shprehimisht me kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, të parashikuara nga neni 131 i Kushtetutës, në praktikën e kësaj gjykate nuk janë të pakta rastet që, për t’u dhënë rrugë çështjeve si në shqyrtimin paraprak në kolegje, ashtu dhe në

seanca plenare, është interpretuar termi “proces i rregullt ligjor”. Natyrisht, duhet të sqarohet, se në rastet në fjalë interpretimi është përdorur si një komponent i metodës së kontrollit kushtetues dhe jo si ushtrim i kompetencës, të parashikuar në nenin 124 të Kushtetutës (domethënë interpretimi përfundimtar i saj).

Nga studimi në tërësi i çështjeve konkrete të shqyrtuar ka dalë se për kuptimin dhe zbatimin në praktikë të konceptit “proces i rregullt ligjor” ka pasur kujdes të veçantë. Kërkesat e shqyrtuara kanë qenë vetëm për procese gjyqësore penale, civile ose administrative dhe vetëm në një rast për proces administrativ (jashtëgjyqësor).

E shoh të nevojshme të theksoj se në ndonjë vendim të veçantë të Gjykatës, madje që në vitet e para të ekzistencës së saj, është bërë përpjekje për kuptimin e sqarimin e konceptit “proces i rregullt ligjor”. Ndërsa përpjekjen për një përkufizim pothuajse të plotë e gjejmë në vendimin nr.11, datë 21.5.1997 ku për nenin 38 të dispozitave kryesore kushtetuese (pak a shumë analoge me nenin 42 paragrafi i parë i Kushtetutës), arsyetohet: “Problemi i shkeljes së nenit 38 në fjalë lind kur një palë u drejtohet organeve gjyqësore të zakonshme ose atyre administrative për njohjen e një të drejt të cenuar prej të tjerëve dhe gjatë gjykimit të çështjes nga organet e sipërme është shkelur një nga parimet esenciale për zhvillimin e rregullt të një procesi gjyqësor”.

Sipas mendimit tim ky definicion i ka qëndruar kohës. Në tërësi vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si ato të kolegjeve (në diskutimin e kompetencës), ashtu dhe ato të seancave plenare, kur ka ardhur puna për të konkluduar nëse në rastet në fjalë ka pasur ose jo një proces të rregullt, u janë referuar parimeve themelore të gjykimit, duke pasur kujdes që as mos të zgjerojnë pa vend e as të mos ngushtojnë këtë koncept, sepse të dyja skajet janë të gabuara.

Zgjerimi pa kriter i kuptimit të konceptit “proces i rregullt” do të çonte në zëvendësimin e kontrollit kushtetues në një kontroll rutinë, që bëjnë gjykatat e shkallëve të ndryshme. Nga ana tjetër ngushtimi, po pa

kriter, do të cenonte drejtpërdrejt të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve, duke e bërë në këtë mënyrë kontrollin kushtetues të paefektshëm.

Kjo trajtesë nuk ka qëllim për caktimin e një definicioni të konceptit të diskutuar, por tërheqjen e konkluzioneve nga praktika e Gjykatës Kushtetuese me qëllim që zgjidhja e problemit rast pas rasti të jetë e drejtë e në përputhje me detyrat e Gjykatës Kushtetuese.

Me këtë rast theksoj, se edhe në literaturën juridike (me aq sa jemi në dijeni) nuk është arritur në një definicion të plotë e të saktë të koncepteve “proces i rregullt” ose “proces equitabel”. Megjithatë pak a shumë është arritur në përfundim, se fjala është për respektimin e garancive procedurale, të cilat janë shpallur nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. “Duhet pranuar se neni 6 (i Konventës A.K.) skicon ndonëse në terma disi të papërcaktuar, kuptimin e garancive procedurale që shpall Konventa” lexojmë tek një autor, i cili më tej vazhdon se koncepti “proces equitabel”, sipas analizave s’është gjë tjetër veçse zhvendosja në të drejtën procesuale i idesë të “fair playt” (lojës së pastër).

Mund të sillja edhe argumente të tjera për të vërtetuar se

a) koncepti “proces i rregullt” i përket në tërësi anës procedurale të procesit, ndryshe nga koncepti “proces i drejtë” ku përparësi merr ana materiale e tij (themeli);

b) në kuptim të gjerë, çdo shkelje sado e vogël e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt. Megjithatë, jo çdo shkelje është objekt i kontrollit kushtetues nga Gjykata Kushtetuese. Shkeljet, si rregull i përgjithshëm, janë objekt i shqyrtimit kasacional, ato bëhen objekt i gjykimit konstitucional kur kanë të bëjnë me parime themelore të procesit, shkelje këto që prekin drejtpërdrejt lirinë, pronën dhe të drejtat e tjera kushtetuese të individit. Lidhur me këtë, në vendimin nr.43, datë 7.7.2000 të Gjykatës Kushtetuese, gjejmë mendimin e pakicës të formuluar në këtë mënyrë: “Zbatimi i gabuar i dispozitave procedurale jo gjithmonë është baraz me proces të parregullt. Të pranosh të kundërtën, atëherë çdo shkelje me karakter procedural, e cila në një formë ose në një tjetër ka ndikuar në të

drejttat themelore, do të përbënte një proces të parregullt e për pasojë, objekt shqyrtimi për Gjykatën Kushtetuese, çka do ta kthente këtë të fundit padrejtësisht në një instancë të lartë të sistemit gjyqësor”.

Për vitet 1997-1999, mëse 34 për qind e vendimeve të dhëna nga Gjykata Kushtetuese kanë pasur për objekt shkeljet e të drejtave nga një proces ligjor i parregullt. Po kështu, janë mëse gjysma e vendimeve të kolegjeve që kanë shqyrtuar paraprakisht kërkesa me këtë objekt.

Duke shqyrtuar në tërësi praktikën e Gjykatës Kushtetuese, kemi arritur në përfundimin, se edhe pse kjo Gjykatë nuk ka bërë interpretimin e nenit 42 të Kushtetutës, me vendimet e saj, duke zgjidhur çështje konkrete, ka hedhur piketat për një kuptim e zbatim sa më të drejtë të konceptit “proces i rregullt ligjor”.

Meqënëse kërkesat e shqyrtuara kanë qenë përgjithësisht për vendime gjyqësore, edhe referimi në parimet themelore ka qenë për fushat e procesit gjyqësor civil, penal e administrativ.

Në tërësinë e vendimeve, vëmendje tërheqin për nga sasia dhe problematika ato që kanë të bëjnë me cenimin ose mohimin e të drejtës së mbrojtjes në proces. Kështu, janë konsideruar si “proces i rregullt” gjykimet nga gjykata e apelit ose Gjykata e Lartë e rekurseve, pa u vënë në dijeni, sipas ligjit, i pandehuri ose pala përkatëse, pengimi për të bërë ankim ndaj vendimeve ose mospranimi i ankimeve për shqyrtim pa shkak ligjor. Në lidhje me ankimin, duke shqyrtuar e zgjidhur një çështje që i përkiste Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese ka shpallur antikushtetus e ka shfuqizuar vendimin përkatës me anë të të cilit bëhej edhe unifikimi i praktikës gjyqësore. Fjala ishte për mbrojtjen në të gjitha shkallët e gjykimit të të pandehurve në mungesë, familjarët e të cilëve caktojnë mbrojtës me akt-përfaqësimi. Gjykata Kushtetuese e konsideroi mohimin e kësaj të drejte si shkelje të neneve 31 e 43 të Kushtetutës, të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të nenit 2 të Prokollit nr.7 të kësaj Konvente dhe të nenit 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe e

shfuqizoi vendimin përkatës, duke e konsideruar se është rezultat i një procesi të parregullt gjyqësor.

Paanësia në gjykim ka qenë një ndër drejtimet ku Gjykata Kushtetuese ka konkretizuar procesin e rregullt ligjor. Në vendimin nr.48 të vitit 1999, midis të tjerash Gjykata është shprehur: "... shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi ligjor të parregullt, që konsiston në cenimin e parimit kushtetues të paanshmërisë së gjykatës. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegjet e Bashkuara, në përbërje të trupit gjykues kanë marrë pjesë edhe dy anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët, lidhur me personin konkret, janë shprehur dhe kanë dhënë mendimin e tyre, duke votuar në këtë organ. Pikërisht, pjesëmarrja e dy gjyqtarëve, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është ... një garanci më pak për kërkuesin".

Edhe pse mund të duket shkelje me karakter formal, rezultat mbase i gabimeve administrative, Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar si shkelje të Kushtetutës ekzistencën e dy vendimeve gjyqësore për një çështje nga Gjykata e Kasacionit. "Meqenëse vendimi është sintezë e gjithë gjykimit, - thuhet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.76 të vitit 1998, - nuk mund të quhet proces i drejtë dhe i rregullt kur jepen dy vendime të ndryshme për të njëjtën çështje gjyqësore". Vendimi vazhdon: "Dhënia e dy vendimeve të ndryshme për të njëjtën çështje nuk është një shkelje formale, por një cenim i rëndë i parimeve kushtetuese të dhënies së drejtësisë". Për më tepër, në një rast tjetër analog që i përket po Gjykatës së Kasacionit, Gjykata Kushtetuese shprehet se në rastin e dhënë cenohet parimi i rëndësishëm se vendimet e gjykatave mund të prishen vetëm nga një gjykatë më e lartë në kushte dhe për shkaqe të parashikuara në ligj (vendimi nr.75/1998). Edhe shqyrtimi i çështjes, kur kërkuesi në bazë të ligjit nuk legjitimohet të bëjë padi, është proces i parregullt (vendimi 48/1998).

Pa i marrë rastet një për një, na lejohet të themi se praktika e Gjykatës Kushtetuese në vendime të veçanta ka konsideruar proces të parregullt ligjor

(e për pasojë antikushtetues) edhe ato procese gjyqësore ku nuk është zbatuar vendimi konkret i Gjykatës Kushtetuese. Kjo për arsyen e vetme, se fuqisë detyruese të përgjithshme të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të parashikuar shprehimisht nga Kushtetua, i nënshtrohen të gjithë organet, pa përjashtuar Gjykatën e Lartë, e cila po sipas Kushtetutës i nënshtrohet asaj (Kushtetutës), si dhe ligjeve. Çdo vendim i marrë në kundërshtim me këto norma është i pavlefshëm si në kuptimin kushtetues e ligjor, ashtu dhe në kuadrin etik.

Nga praktika e Gjykatës Kushtetuese kanë dalë edhe disa probleme, diskutimi i të cilave mund të ndikojë në evoluimin e pasurimin e koncepteve konkrete.

1) Po t'i referohesh veçanërisht vendimeve të kolegjeve, ato në tërësi paraprakisht i kanë konsideruar pa bazë e shkak kërkesat me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve gjyqësore për shkaqe që kanë të bëjnë me marrjen e vlerësimit e provave. Përgjithësisht mendimi ka qenë se ky proces ka të bëjë në fund të fundit me vlerësimin subjektiv të gjykatës së faktit, vlerësim, i cili nuk mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues të Gjykatës Kushtetuese. Ndonëse unë e mbështes këtë praktikë, shtroj disa probleme: Është e drejtë që mënyra e zbulimit, e administrimit të provave të mos jetë pjesë integrale e “procesit të rregullt” në kuptimin kushtetues. Po si do të trajtohen rastet kur provat janë siguruar në mënyrë të kundërligjshme e në ndonjë rast kriminale? Në një rast, një nga kolegjet, kaloi për gjykim në seancë plenare një kërkesë, ku midis të tjerave pretendohet se pronat, të cilat kishin shërbyer si bazë për deklarimin fajtor e dënimin e kërkuesit, ishin marrë me torturë. Në marrjen e këtij vendimi, kolegji u nis veçanërisht nga fakti se mospërdorimi ose më mirë të themi ndalimi i torturës, veçse është obligim e garanci kushtetuese, është njëkohësisht një obligim ndërkombëtar. Por problemi shtrohet më gjerë: a do të përbëjë proces të parregullt (gjithmonë në aspektin kushtetues) një

proces i bazuar në prova të marra në mënyrë të kundërligjshme? Unë, në këtë trajtesë nuk marr përsipër të jap receta, veçse shfaq mendimin se kjo çështje duhet të zgjidhet rast pas rasti, në përputhje me rëndësinë e shkëljes, rëndësinë në proces të provave të marra në rrugë të paligjshme etj. Në këto çështje, kam mendimin se larg përkufizimeve strikte, Gjykata Kushtetuese duhet të jetë elastike në qëndrimet e veta, duke u ndikuar jo vetëm nga shkronja po dhe nga fryma e Kushtetutës dhe e akteve ndërkombëtare. Edhe në këtë drejtim ne kemi ç' mësojmë nga praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

2) Shpesh ka qëlluar që në kërkesa si shkak sillen argumente për moszbatimin ose zbatimin në mënyrë të gabuar të ligjeve materiale nga ana e gjykatave. Këto kërkesa në tërësi nuk janë pranuar për t'u kaluar në gjykim. Nga praktika disavjeçare e Gjykatës Kushtetuese, vetëm në një rast ka kaluar për gjykim një kërkesë e një të dënuar i cili pretendonte se gjykatat e kishin dënuar me ligjin e ri në vend që ta dënonin me ligjin e kohës së kryerjes së veprës penale, i cili ishte më favorizues (vendimi nr.27/1996).

Zbatimi i ligjit material, në raste të veçanta, mund të përbëjë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese. Kështu, jam dakord se interpretimi i ligjit material i takon atij që e zbaton e si rrjedhim, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta vlerësojë atë, por jam gjithashtu dakord që të paktën në rastet, kur vendimi gjyqësor bazohet mbi një akt ligjor të shfuqizuar, ai duhet konsideruar si rezultat i një procesi të padrejtë.

Më komplekse bëhen rastet kur kërkuessit pretendojnë se procesi gjyqësor (e vendimi si pjesë e tij) janë mbështetur mbi një ligj antikushtetues. Edhe pse kërkesa të kësaj natyre nuk ka pasur, problemi vlen të diskutohet, sepse ai shpesh ka qenë objekt bisedash e debatesh në Gjykatën Kushtetuese.

Nëse një ligj është ose jo kushtetues, kjo nuk varet nga çmimi që i bën kërkuessi si individ, por nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, e cila për këtë rast, sipas Kushtetutës, vihet në lëvizje nga një sërë subjektsh, por jo nga individët. Për rrjedhim, në pamje të parë, në bazë të Kushtetutës, duket se individët nuk legjitimohen të paraqesin në Gjykatën Kushtetuese kërkesa

për shfuqizim të vendimeve gjyqësore, kur pretendohet se ato janë mbështetur mbi akte antikushtetuese.

Megjithatë, për mendimin tim, situatën e zgjidh ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” në nenin 48/2 të të cilit, lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes, është shprehur se “... kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative, vendos për çdo rast Gjykata Kushtetuese”.

Shqyrtimi i kësaj dispozite na lejon të konkludojmë se:

a) ajo koneksitetin nuk e shtrin vetëm në rastet e shqyrtimit të kushtetushmërisë së një dispozite, por në të gjitha çështjet ku objekti i kërkesës lidhet edhe me akte normative;

b) nëse ka koneksitet dhe nëse zgjidhja e problemit të kushtetushmërisë së ligjit duhet t’i paraprijë shqyrtimit të kushtetushmërisë së vendimit gjyqësor, këtë duhet ta zgjidhë për çdo rast me vendim Gjykata Kushtetuese. Një interpretim dhe zgjidhje e tillë e këtij problemi është në favor të mbrojtjes e garantimit të të drejtave e lirive të individëve. Ajo në një farë mënyre është edhe një element i kontrollit kushtetues të Gjykatës Kushtetuese dhe i garantimit prej saj të zbatimit të Kushtetutës në veprimtarinë e organeve gjyqësore.

Roli i Presidentit të Republikës në procesin ligjvënës.

Vetoja është instrument politik apo instrument kushtetues?

Theodhori Sollaku

Në republikat parlamentare, siç është edhe Republika e Shqipërisë, Kryetari i Shtetit ka pushtete të kufizuara, kryesisht kompetenca të karakterit honorifik e simbolik. Edhe në aspektin e procesit ligjvënës roli i Kryetarit të Shtetit është tepër i kufizuar. Edhe ndërhyrja e tij në këtë proces është e këtij karakteri. Kushtetuta e re ndërhyrjen e Presidentit të Republikës në procesin ligjvënës e kufizon së tepërmi. Kështu, sipas Kushtetutës, në dallim nga ligji i mëparshëm kushtetues, Presidenti nuk ka të drejtën e nismës ligjvënëse ose të drejtën e nxjerrjes së dekreteve normative në kohë paqeje. Heqja e këtyre dy kompetencave u argumentua me vendosjen e raporteve të reja, më të drejta midis kompetencave të Qeverisë dhe Presidentit, duke i dhënë përparësi të parës, gjithnjë nisur nga fakti që sa më pak aktiv të jetë në fushën ekzekutive e ligjvënëse Presidenti, aq më shumë do të ulen risqet për të qënë ai në fokusin e goditjeve dhe të pakënaqësive të popullit, dukuri këto që për qeveritë duken normale. Kushtetuta në nenin 84 pika 1 të saj shprehet se “Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar nga Kuvendi brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij”. Këtë kompetencë të Kryetarit të Shtetit do ta ndeshim gati në të gjithë kushtetutat dhe po me të njëjtin formulim. Megjithëse e karakterit simbolik e honorifik, kjo kompetencë në vetvete është e rëndësishme nga ana formale kushtetuese, sepse paraqitet si pjesë e procesit të bërjes së ligjit. Ligji, megjithëse mund të jetë miratuar nga Kuvendi, nuk mund të quhet ligj dhe të prodhojë efektet e tij, të paktën për

20 ditë pas miratimit në Kuvend, nëse nuk është fimosur nga Presidenti i Republikës. Themi, të paktën për 20 ditë sepse Kushtetuta, në pikën 2 të nenit të cituar më sipër, parashikon që nëse Presidenti nuk e ushtron të drejtën e shpalljes së ligjit, me kalimin e afatit 20-ditor, ligji konsiderohet se është shpallur dhe pas kësaj mund të fillojnë procedurat e botimit të tij në Fletoren Zyrtare. Ndryshe nga ligji i mëparshëm “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me Kushtetutën e re afati është 20 ditë, nga 15 ditë që ishte me ligjin e mëparshëm kushtetues, dhe se tashmë afati fillon nga dita që i është paraqitur Presidentit dhe jo nga dita e miratimit në Kuvend, siç parashikohej në ligjin e mëparshëm. Mendoj se përcaktimi i saktë i këtij çasti në Kushtetutë shmang keqkuptimet potenciale që mund të lindin gjatë miratimit të ligjeve. Gjithashtu, në dallim nga ligji i mëparshëm kushtetues, Kushtetuta e re solli një evolucion përse i përket rasteve të hyrjes në fuqi të ligjit para afatit 15 ditor pas botimit në Fletoren Zyrtare. Është e natyrshme që shteti nuk duhet t’i lidhë duart vetes në situata të veçanta, kur rregullimi i një marrëdhënieje është i domosdoshëm të bëhet në një afat shumë të shkurtër, duke mos pritur kalimin e 15 ditëve nga botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare. Këto raste janë të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë dhe lidhen, së pari me situata të gjendjes së jashtëzakonshme dhe, së dyti, me rastet e nevojës dhe të urgjencës.

Neni 84 pika 4 i Kushtetutës parashikon që për të hyrë ligji menjëherë në fuqi nuk mjafton vetëm ekzistenca e rrethanave të mësipërme, por duhet që të japë pëlqimin paraprak Presidenti i Republikës dhe më tej ligji të bëhet i njohur publikisht e të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare. Pra, duhet të konkurrojnë disa elemente së bashku, që të mund të bëhet përjashtimi nga rregulli, tashmë i njohur nga të gjithë që “ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Nuk do të analizoj të gjithë këto elemente, por do të ndalem në dhënien e pëlqimit paraprak nga Presidenti i Republikës në këto raste.

Në cilat raste Presidenti duhet të japë pëlqimin dhe në cilat raste jo, është një çështje që zgjidhet rast pas rasti dhe Kushtetuta e ka lënë në

gjykimin individual të Presidentit të Republikës. Për të marrë vendim në raste të tilla, mendojmë se i rëndësishëm është argumentimi nga Qeveria dhe Kuvendi i kërkesës që i drejtohet Presidentit të Republikës. Pra, sa bindës do të jetë argumentimi për të krijuar idenë se vërtetë jemi në situatë nevojë dhe urgjence dhe se ligji që miratohet është tepër i domosdoshëm dhe duhet të hyjë në fuqi menjëherë. Në praktikën e deritanishme pas miratimit të Kushtetutës, ka pasur raste, megjithëse të pakta, që është dhënë pëlqimi për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit. Këto raste kanë qenë të lidhura kryesisht me ligjin për Buxhetin e Shtetit, me miratimin e disa marrëveshjeve nga të cilat shteti ynë përfitonte grande të rëndësishme etj.. Megjithatë, edhe në këto raste, duhet pasur shumë kujdes për të mos shndërruar përjashtimin nga rregulli, në rregull.

Shtrohet pyetja: Përse është e nevojshme që, pas miratimit nga Kuvendi, për t'u quajtur ligj dhe për të prodhuar efektet, ky akt duhet të nënshkruhet edhe nga Kryetari i Shtetit? Mos vallë është hallkë e tepërt ndërhyrja e Presidentit të Republikës në procesin ligjvënës? Përse duhet edhe kjo ndërhyrje gjatë këtij procesi? Përgjigjja e kësaj pyetjeje është e lidhur me parimin që vendos Kushtetuta në ndërtimin e pushteteve dhe në marrëdhëniet midis tyre, në atë qenë e quajmë *check and ballance*. Pikërisht, futja e Presidentit të Republikës në këtë proces i shërben pikërisht këtij parimi. Shpallja e ligjit nga Presidenti është nga njëra anë akt solemniteti, po nga ana tjetër është edhe një çast kontrolli, një *check* që i bëhet Kuvendit dhe që ushtrohet me anë të vetos nga Presidenti i Republikës. Shpallja e ligjit ose vendosja e vetos nga Presidenti i Republikës është një çast i rëndësishëm kontrolli, veçanërisht në ato vende ku parlamenti është i ndërtuar me një dhomë, siç është parlamenti ynë. Mungesa e dhomës së dytë e senatit, e cila siç dihet shërben veç të tjerash edhe si hallkë kontrolli e dhomës më të ulët gjatë procesit ligjvënës, bën që ndërhyrja e Presidentit të Republikës në finalizimin e procesit ligjvënës të marrë një rëndësi të veçantë.

Sipas nenit 85 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës ka të drejtë të kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë në Kuvend. Në këtë rast ligji duhet rimiruar me një shumicë absolute, pra me shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, në dallim nga ligji i mëparshëm kushtetues, i cili parashikonte një shumicë të thjeshtë, pra shumica e të pranishmëve në sallë. Në këtë aspekt Kushtetuta ka sjellë një forcim të vetos së Presidentit, pasi kërkohet një numër më i madh deputetësh për ta rrëzuar atë.

A është vetoja e Presidentit një çast politik apo një çast kushtetues? Unë mendoj se ajo është edhe çast politik dhe çast kushtetues. Është çast kushtetues sepse buron nga dispozita kushtetuese (neni 85) dhe është çast politik sepse Kryetari i Shtetit, pavarësisht se Kushtetuta e cilëson si njeri jopartiak, si figurë që duhet të qëndrojë mbi partitë, në thelb është figurë politike, madje figura më e rëndësishme politike në shtet, që përfaqëson unitetin e popullit. Në këtë aspekt, gjykimi i Kryetarit të Shtetit gjatë ushtrimit të vetos është një gjykim edhe politik, theksoj politik dhe jo partiak. Historia e këtyre 9 vjetëve të institucionit të Presidentit të Republikës, si kryetar shteti monokratik, tregon se vetoja është përdorur në disa raste nga Presidenti i Republikës.

Me të drejtë shtrohet pyetja: Për cilat shkaqe Presidenti i Republikës mund të ushtrojë të drejtën e vetos ndaj një ligji, pra kur ai mund ta kthejë një ligj për rishqyrtim Kuvendit? Kushtetuta nuk shprehet për këtë, duke e lënë në gjykimin e Presidentit të Republikës, se për cilat shkaqe ai mund ta kthejë një ligj. Analiza e shkaqeve të ushtrimit të vetos nga Kryetari i Shtetit gjatë këtyre viteve tregon se si shkaqe mund të shërbejnë: gjykimi si antikushtetues i një ligji, konstatimi i kontradiktave midis ligjit të miratuar dhe një ligji të mëparshëm, kontradikta brenda vetë ligjit etj. Po kështu, historia e këtyre viteve tregon se vetoja mund të ushtrohet edhe për shkaqe politike, megjithëse ligji mund të jetë në rregull nga ana kushtetuese, i ndërtuar në përputhje me teknikat ligjvënëse, i harmonizuar me ligjet e tjera, por megjithatë gjykohet se ai nuk është i përshtatshëm për çastin ose për shkaqe politike e sociale ka nevojë të riformulohet në mënyrë tjetër.

Vetoja, për shkaqe politike dhe e bërë në çastin e duhur, është tepër e justifikuar nëse do të kemi parasysh rolin e Presidentit të Republikës si përfaqësues i unitetit të popullit. Ushtrimi i kësaj kompetence, që është ekskluzive e Presidentit të Republikës, gjithnjë është në çmimin e Kryetarit të Shtetit dhe nuk mund t'i kërkohet llogari atij se përse në këtë rast vendosi veton dhe në një rast tjetër, ndoshta të ngjashëm me të parin, nuk e ka vendosur atë, por ka shpallur ligjin. Historia e këtyre viteve ka treguar se 3 kryetarët e shtetit kanë qenë shumë të matur në vendosjen e vetos ndaj ligjeve të parlamentit dhe statistikisht flasin për 11 raste kur Presidenti i Republikës ka vendosur veton ndaj ligjit (1, 4, 6). Së fundi dua të them se ushtrimi i kësaj kompetence varet shumë nga situata politike në vend, si dhe nga natyra e vetë personit që është Kryetar Shteti.

Siç u tha, Presidenti i Republikës mund ta kthejë ligjin kur vëren se ai vjen ndesh me dispozitat kushtetuese. Mund të shtrohet me të drejtë pyetja: Si ka mundësi të shprehet Presidenti i Republikës për pakushtetushmëri të ligjit, kur në bazë të Kushtetutës një kompetencë të tillë e ka vetëm Gjykata Kushtetuese? Natyrisht shqetësimi që ngrihet në këtë pyetje është i drejtë, por në këto raste bëhet fjalë për antikushtetushmëri të dukshme si, për shembull, nëse ligji parashikon të drejtën e Kuvendit të shkarkojë gjyqtarët e shkallës së parë, kur kjo e drejtë është e KLD-së etj. Zgjidhje më të drejtë për këto raste jep Kushtetuta Franceze, e cila shprehet se kur Presidenti gjykon se ligji është antikushtetues, ai nuk ka të drejtë t'ia kthejë Asamblesë Kombëtare, por ia dërgon atë për shqyrtim Këshillit Kushtetues, si organi i vetëm kompetent për këtë, të vendosë në lidhje me kushtetushmërinë e një ligji. Nëse Këshilli Kushtetues do të vendosë që ligji nuk ka probleme kushtetushmërie, Presidenti është i detyruar ta shpallë ligjin. Në të kundërt, Këshilli Kushtetues ia dërgon ligjin për rishqyrtim Asamblesë Kombëtare. Kjo është një nga zgjidhjet e veçanta të kushtetutave të Europës, por karakteristike për të gjitha kushtetutat e republikave parlamentare është formulimi që përmend edhe Kushtetuta jonë. Pra, thjeshtë "Presidenti ka të drejtë të kthejë ligjin".

Megjithëse Kushtetuta nuk shprehet, kthimi i ligjit në Kuvend për rishqyrtim edhe njëherë, duhet të motivohet. Në relacionin që i bashkëngjitet dekretit të kthimit të ligjit, Presidenti i Republikës duhet që të argumentojë vendimin e tij për kthimin e ligjit. A mundet që në relacion të sugjerojë edhe zgjidhje konkrete? Unë mendoj se nuk ka pengesë që Kryetari i Shtetit të sugjerojë zgjidhje konkrete të ligjit, por nga ana tjetër duhet pranuar se sugjerimet nuk janë të detyrueshme për t'u shqyrtuar nga Kuvendi. Nëse do të ishte ndryshe, atëherë do të ishim para një nisme ligjvënëse të ushtruar nga Presidenti i Republikës, që në fakt Kushtetuta nuk ia jep këtë të drejtë.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Ligji nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mënyrën e zhvillimit të lojërave të fatit, të kazinove dhe të basteve, të cilat vihen për garat e zhvilluara në hipodrome, si dhe për licencimin e organizatorit të tyre. Ligji përcakton se cilat lojëra quhen lojëra fati dhe cilat nuk quhen të tilla. Ai saktëson edhe kategoritë e tyre, duke i ndarë në 4 kategori: lojëra aritmetike, lojëra fati sportive, llotari dhe lojëra elektronike. Gjithashtu, rregullohet mënyra e dhënies së lojes organizatorit, detyrimet e tij, revokimi i lejës etj. Rregullime të tilla bëhen edhe për kazinotë dhe hipodromet. Për shkeljen e rregullave të vendosura me këtë ligj, për të gjitha llojet e veprimtarive, janë parashikuar edhe sanksione. Me miratimin e këtij ligji është shfuqizuar ligji nr.7871, datë 9.11.1994 “Për lojërat e fatit dhe kazinotë”. Ligji ka 32 nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.45, 2000, faqe 1996.

Ligji nr.8702, datë 1.12.2000 “Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermave blegtorale”. Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve dhe i fermave me drejtim blegtoral sot është një nga problemet themelore të blegtorisë, ndaj të cilit po tregohet një vëmendje e veçantë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, si dhe nga vendet që po përgatiten të futen në këtë organizëm në të ardhmen. Qëllimi i këtij ligji është të përafrojë legjislacionin shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European, për t’i bërë më të lehtë shkëmbimet e ndërsjella të të dhënave dhe kontrollit për eksport-importin e

kafshëve të gjalla nga dhe në këto vende. Gjithashtu, me këtë ligj disiplinohet lëvizja e kafshëve nëpërmjet shoqërimit të tyre me kartela, vihet nën kontroll situata sanitaro-veterinare nëpërmjet lëvizjeve dhe therjeve të kontrolluara etj. Për hartimin e këtij ligji është shfrytëzuar legjislacioni aktual i BE-së dhe janë mbajtur parasysh mendimet dhe vërejtjet e dhëna nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Vendor. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr.47/2000, ka 12 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.1.2001.

Ligji nr.8703, datë 1.12.2000 “Për ratifikimin e “Konventës Europiane për informimin për të drejtën e huaj””. Miratimi i këtij ligji synon njohjen institucionale të së drejtës së huaj në fuqi nga ana e autoriteteve të shtetit shqiptar, si dhe krijimin e një sistemi të ndihmës së ndërsjellë shtetërore për lehtësimin e detyrave të autoriteteve gjyqësore në marrjen e informacionit për të drejtën e huaj. Me ratifikimin e Konventës, shtetet pjesëmarrëse në të marrin përsipër detyrimin për të dhënë informacion për legjislacionin e tyre në fushën civile dhe tregtare, si dhe në fushën e organizimit të tyre gjyqësor. Parashikohet që shkëmbimi i të dhënave të realizohet nga një organ shtetëror (nga një departament ministrie). Gjithashtu, në Konventë rregullohet në detaje përmbajtja e kërkesës për të dhëna, transmetimi i tyre, detyrimi për t’u përgjigjur nga ana e organit marrës dhe përjashtimet nga ky detyrim, afati i komunikimit të kërkesës, të të dhënave që mund të jepen, gjuhët në të cilat jepen këto të dhëna, si dhe mbulimi i shpenzimeve që mund të bëhen gjatë këtij procesi dhe që do të mbulohen nga ai organ që kërkon të dhëna. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.11.2000. Është botuar së bashku me Konventën Europiane për informimin për të drejtën e huaj në Fletoren Zyrtare nr.4/2000, faqe 1960.

Ligji nr.8704, datë 1.12.2000 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së

Republikës Franceze për konsolidimin e borxhit (në bazë të termave të referencës së “Klubit të Parisit”)”. Ky ligj ratifikon një marrëveshje midis dy qeverive për konsolidimin e borxhit që Republika e Shqipërisë ka ndaj Qeverisë së Republikës Franceze, në mbështetje të termave të referencës së Klubit të Parisit të tetorit 1999. Në mbështetje të kësaj Marrëveshjeje, shumat e principalit dhe të interesit që i duheshin paguar COFACE (Kompania Franceze e Sigurimit për Tregtinë e Jashtme) që nga 30 shtatori 1999 deri më 30 shtator 2000, të cilat nuk janë paguar dhe që përbëhen nga 2.915.067 USD dhe 1.758 077 EURO do të shtyhen dhe do të paguhen me 10 këste të barabarta e të njëpasnjëshme gjashtëmujore, duke filluar nga 30 qershori 2001. Kjo Marrëveshje është miratuar në parim me vendimin nr.298, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.1.2001. Është botuar së bashku me Termat e Referencës në Fletoren Zyrtare nr.45/2000, faqe 2006.

Ligji nr.8705, datë 1.12.2000 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes Europiane për transmetimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore””. Në Kodin e Procedurës Civile parashikohet edhe njoftimi i akteve të shtetit të huaj dhe dhënia e ndihmës juridike nga gjykatat e shteteve të huaja dhe për gjykatat e shteteve të huaja. Në kushtet e bashkëpunimit dhe të varësisë së ndërsjellë ndërmjet vendeve europiane dhe vendit tonë nuk mund të zgjidhen problemet për dhënien e ndihmës gjyqësore në fushën civile e më gjerë vetëm duke mbajtur për bazë juridiksionin e bazuar në teritorialitetin, prandaj ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje me ligjin e lartpërmendur shënon për herë të parë pranimin e normave juridike ndërkombëtare të karakterit shumëpalësh në dhënien e ndihmës gjyqësore në fushën civile. Kjo do të shërbejë për të hequr çdo pengesë ekonomike që dëmton të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës dhe, nga ana tjetër, të vlerësojë më mirë të drejtat e personave ekonomikisht të pafavorizuar. Duke pranuar këto norma të së drejtës ndërkombëtare do të mundësohet zgjerimi i juridiksionit të autoriteteve tona gjyqësore jashtë

territorit shqiptar dhe anasjelltas, pra autoriteti gjyqësor i një vendi tjetër të shtrihet edhe brenda territorit shqiptar. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.11.2000. Është botuar së bashku me Marrëveshjen Europiane për transmetimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore në Fletoren Zyrtare nr.43/2000, faqe 1966.

Ligji nr.8706, datë 1.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar të Qendrës Europiane të gjuhëve moderne”, në Graz të Austrisë”. Me ligjin e lartpërmendur krijohen mundësi për thellimin e bashkëpunimit të vendit tonë me Qendrën, duke shumëfishuar veprimtaritë e programuara, atelietë, seminarët, kolokiumet, rrjetet e kërkimit shkencor të zhvillimit të politikave gjuhësore, këshillimet ndërmjet specialistëve, asistencën e veçantë, shkëmbimin e dokumentacionit etj.Gjithashtu, përcaktohen objektiva konkrete e programe afatshkurtëra e afatmesme për politikën e mësimdhënies e të asimilimit të gjuhëve moderne sipas kushteve konkrete të vendeve pjesëmarrëse në marrëveshje dhe mbi bazën e inovacioneve për mësimin e mësimdhënien e gjuhëve moderne.Në kuadrin e Paktit të Stabilitetit pjesëmarrja jonë në këtë marrëveshje shihet si një sinjal politik pozitiv për gatishmërinë e vendit tonë në politika europiane të mësimin të gjuhëve të huaja. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.11.2000. Është botuar së bashku me Rezolutën (98)11 “Për vazhdimësinë e Qendrës Europiane të Gjuhëve Moderne” në Fletoren Zyrtare nr.43/200, faqe 1971.

Ligji nr.8708, datë 1.12.2000 “Për disa përjashtime dhe për dhënien e disa stimuljeve për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit me koncesion të formës BOT”. Këshilli i Ministrave me vendimin nr.222, datë 24.5.1997 ka miratuar Marrëveshjen me koncesion të formës BOT për ndërtimin e HEC-it të Kalivaçit mbi lumin Vjosë, me shoqërinë italiane BEG s.p.a, në përputhje me nenin 1 të ligjit nr.8105, datë 28.3.1996 “Për

një ndryshim në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë””. Shoqëria italiane BEG s.p.a. ka punuar për sigurimin e financimit dhe vazhdon të shprehë interes për ecurinë e kësaj marrëveshjeje, e cila përmban disa përjashtime nga ligji për koncensionet dhe parashikon dhënien e disa stimuljve, sipas nenit 14 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”. Pra, ky ligj mbështet Marrëveshjen me përjashtimin nga detyrimet e importit dhe çdo lloj takse që lidhet me importin dhe eksportin e mallrave dhe të shërbimeve për të gjithë periudhën e koncensionit. Kjo mbështetje jepet edhe për faktin se koncensionit ka marrë përsipër të kryejë me shpenzimet e tij shpronësimet e pronave private, rindërtimin e segmentit të rrugës kombëtare Ballsh-Memaliaj etj. Ligji ka 7 nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.45/2000, faqe 2010.

Ligji nr.8709, datë 6.12.2000 “Për miratimin e “Konventës për shitjen e aseteve të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë”” Në emër të Qeverisë Shqiptare, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit lidhin kontratën me “Fushë-Kruja Cement Factory” sh.p.k. për shitjen e aseteve të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos në Fushë-Krujë. Pala blerëse ka kërkuar që kontrata e shitjes të miratohet me ligj, kërkesë e cila është shënuar në këtë kontratë. Pra ligji miraton kontratën si shprehje e vullnetit të ligjvënësit për privatizimin e një ndërmarrjeje me vlerë dhe rëndësi të madhe për zhvillimin e industrisë së çimentos. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.1.2001. Është botuar së bashku me kontratën e shitjes në Fletoren Zyrtare nr.45/2000, faqe 2012.

Ligji nr.8710, datë 15.12.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

Me këtë ligj bëhen disa ndryshime në ligjin ekzistues, të cilat rritin mundësinë

e administratës tatimore për të përdorur metodat alternative të përcaktimit të detyrimeve tatimore për mënjanimin e evazionit fiskal i cili manipulon me çmimet e shitjes, duke i vendosur ato në mënyrë të dukshme nën çmimet reale. Në raste të tilla, tani administratës tatimore i jepet e drejta të mos i pranojë këto çmime dhe të përcaktojë detyrimet tatimore me çmimet reale të tregut. Gjithashtu, ky ligj ndalon kryerjen e transaksioneve me lekë në dorë, kur ato kalojnë një vlerë prej 1 milion lekësh, detyron tatimpaguesit të afishojnë çmimet e shitjes së mallrave e të kryerjes së shërbimeve, përcakton më saktësisht disa raste të shmangieve tatimore dhe vendos disa sanksione të reja që kanë të bëjnë kryesisht me përcaktimin e detyrimeve që përmendëm më sipër. Ligji ka 10 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.47/2000, faqe 2061.

Ligji nr.8711, datë 15.12.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”” Ndryshimet që miratohen me këtë ligj kanë të bëjnë me uljen e shkallës tatimore të tatimit mbi fitimin nga 30 për qind në 25 për qind. Njëkohësisht, me uljen e shkallës tatimore të tatimit mbi fitimin nga 30 në 25 për qind, ulet edhe shkalla maksimale e tatimit mbi pagat nga 30 për qind (për pagat mbi 120 mijë lekë) në 25 për qind. Gjithashtu, ligji unifikon disa masa dënimi për shkeljet që bëhen, si dhe ulen disa masa dënimi të shkeljeve kryesore nga 5-fish që është në ligjin ekzistues në 2-fish, duke e unifikuar dhe harmonizuar në këtë mënyrë edhe me shkeljet e parashikuara në ligjet e tjera tatimore, si në ligjin për TVSH-në, për akcizat dhe në ligjin e procedurave tatimore. Ligji ka 9 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.47/2000, faqe 2063.

Ligji nr. 8712, datë 15.12.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8474, datë 14.4.1999 “Për miratimin e nomenklaturës dhe tarifës doganore”, ndryshuar me ligjin nr.8558, datë 22.12.1999”. Ndryshimet që bëhen me

këtë ligj synojnë uljen në vazhdimësi të taksave doganore dhe zbatimin e detyrimeve ndaj OBT-së për krijimin e kushteve më të përshtatshme për thithjen e investimeve të huaja dhe vendase, për stimulimin dhe mbrojtjen e disa degëve të industrisë vendase, si dhe lidhen me disa rregullime të tjera tarifore që synojnë unifikimin e tyre për mallra të njëjtë, duke shmangur njëkohësisht edhe mundësinë e interpretimeve të ndryshme, për rrjedhojë edhe të korrupsionit të punonjësve të administratës doganore. Kështu, tarifa doganore më të ulta, ndërmjet të tjerash, do të kenë makineritë, pajisjet, si dhe lëndët e para etj. Makinat teknologjike për pastrimin e plehërave dhe karrocet e invalidëve do të jenë pa taksë doganore. Ligji ka 11 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.12.2000. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.42/2000, faqe 1921.

Ligji nr.8713, datë 15.12.2000 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë””. Ky ligj synon të ndreqë disa probleme që kanë lindur gjatë zbatimit të ligjit për taksën e solidaritetit për rendin dhe mbrojtjen. Niveli i lartë i kësaj takse, e cila ishte më e lartë se tatimi mbi biznesin e vogël, kishte bërë që shumë subjekte të biznesit ambulant të mos liqencoheshin. Prandaj ligji përjashtoi nga kjo taksë biznesin e vogël ambulant që e zhvillon veprimtarinë në tregjet e miratuara nga organet e pushtetit vendor, si dhe ul në mënyrë të ndjeshme taksën e filialeve në rrethe të subjekteve shtetërore të regjistruara në TVSH. Gjithashtu, hiqet taksa e solidaritetit edhe për punonjësit buxhetorë, jobuxhetorë dhe ata privatë. Ligji ka 11 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.12.2000. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.42/2000, faqe 1924.

Ligji nr.8714, datë 15.12.2000 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar””. Ndryshimet në ligjin ekzistues kanë të bëjnë me shtyrjen e pagesave për

makineritë dhe pajisjet që importohen për t'u investuar në fushën e prodhimit, ndërtimit dhe telekomunikacionit. Kjo bëhet sepse ngurtësimi i një sasive të madhe vlerash monetare, që në hapat e para të investimit, i bën biznesmenët të painteresuar për të investuar ose për të zgjeruar veprimtarinë e tyre ekonomike. Pra, shtyrja e pagesave për makineritë e pajisjet që importohen do të ulë investimin. Sipas këtij ligji, skema e funksionimit të shtyrjes së kësaj lloj pagese, lloji i makinerive dhe i pajisjeve që përfitojnë këtë skemë do të rregullohet me akt nënligjor të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, ky ligj shkurton afatin kohor të së drejtës për t'u rimbursuar nga 6 muaj në 1 muaj, çka do t'u krijojë mundësi eksportuesve të kenë në dorë fonde të lira monetare, pra edhe mundësi më të mëdha për të investuar. Përveç këtyre, me këtë ligj zgjerohet baza e tatueshme e TVSH-së, duke përfshirë në të dhe qiradhënien e tokës dhe të ndërtesave, çka do të çojë në rritjen e të ardhurave nga ky tatim. Ligji ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.47/2000, faqe 2066.

Ligji nr.8715, datë 15.12.2000 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël””. Ndryshimet që bëhen me këtë ligj synojnë krijimin e mundësive ligjore për matjen e vëllimit të xhiros nga subjektet e biznesit të vogël dhe, mbi këtë bazë, për vjeljen e detyrimeve tatimore. Është parashikuar që subjektet e biznesit të vogël, të cilët nuk janë pajisur me arka regjistruese, të përdorin si dokument shitjeje dhe pasqyrimin e xhiros me dëftesën tatimore. Ligji parashikon që subjektet e biznesit të vogël të pasqyrojnë në librat e blerjeve të gjitha blerjet që realizojnë nëpërmjet faturës tatimore ose faturës së thjeshtë. Një ndryshim i tillë bëhet pasi nga praktika e deritanishme, e cila nuk i detyronte këta tatimpagues për të dokumentuar blerjet e mallrave me qëllim rishitjen, ka krijuar probleme në kontrollin e lëvizjes së mallrave nga tregtuesit me shumicë të tregtuesit me pakicë. Me ndryshimin e bërë do të kontrollohen më mirë si tregtarët e shumicës, lidhur me faturimet e

mallrave, ashtu edhe tregtarët e pakicës për saktësimin e vëllimit të xhiros që realizojnë. Gjithashtu, me këtë ligj është riformuluar më saktë kapitulli i shkeljeve dhe i dënimeve penale për njësimin e tyre me shkeljet dhe dënimet penale të parashikuara në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Ligji ka 7 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.47/2000, f.2068.

Ligji nr.8716, datë 15.12.2000 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8507, datë 7.7.1999 dhe ligjin nr.8595, datë 6.4.2000”. Me disa ligje të mëparshme, pagesa e akcizës së alkoolit për prodhim pijesh, kaloi në pijet e forta alkoolike dhe paguhet me blerjen e pullës. Për pasojë u rrit sasia e alkoolit të importuar rreth 3 herë gjatë viteve 1998-1999 në krahasim me vitet 1996-1997. Megjithatë, përsëri ka erozion fiskal në prodhimet e pijeve të forta alkoolike, sepse shumë prej tyre prodhohen nëpër bodrume, pra janë pije alkoolike fallco, dhe po fallco kanë qenë në disa raste edhe pullat fiskale. Me qëllim që të mënjanohen këto dukuri negative, ligji i miratuar ul ngarkesën fiskale (AKCIZË) të pijeve të forta alkoolike (uzo, fërnjet, konjak, uiski etj.) Gjithashtu, ligji pranon e njeh dëmtimin gjatë prodhimit të pullave fiskale të cigareve në masën 0,5 për qind. Ligji ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.47/2000, faqe 2070.

Ligji nr. 8717, datë 15.12.2000 “Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit e të pijeve alkoolike”. Ky ligj është një riformulim i ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 “Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit e të pijeve alkoolike dhe për ngjyrosjen e nënprodukteve të naftës”. Koha bëri të domosdoshëm shfuqizmin e këtij ligji dhe miratimin e ligjit të ri, sepse në ligjin që u shfuqizua, përfshihej edhe ngjyrosja e nënprodukteve të naftës, çka mënjanonte përzierjen e vajgurit me gazoilin nga subjektet importuese të karburanteve, sepse vajguri për konsum nga populli nuk kishte akcizë. Me

ndryshimin e ligjit të akcizave, u vendos që akciza e vajgurit të jetë më e lartë se akciza e gazoilit, pra e bëri të parëndësishme këtë përzjerje. Me këtë ligj synohet edhe forcimi i masave për mbledhjen me forcë të tatimeve, duke i dhënë të drejtë organeve tatimore, që jo vetëm të konfiskojnë, por edhe të mbyllin mjedisin e ushtrimit të veprimtarisë, jo më pak se dy muaj, të atyre subjekteve që tregtojnë mallra pa pullën fiskale të Ministrisë së Financave. Ligji ka 7 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.47/2000, faqe 2072.

Ligji nr.8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001” Sipas ligjit të lartpërmendur fondi i konsoliduar për vitin 2001 është: të ardhurat e Buxhetit të Shtetit 113.877 milionë lekë dhe shpenzimet 167.912 milionë lekë. Pra, deficitin është 54.035 milionë lekë. Burimet për mbështetjen e shpenzimeve buxhetore do të jenë nga të ardhurat tatimore 93.300 milionë lekë, të ardhurat jotatimore 18.977 milionë lekë e të ardhurat e buxhetit lokal 1.600 milionë lekë. Kufiri maksimal i financimit të deficitit të buxhetit të përgjithshëm nga burime të brendshme është 27.313 milionë lekë, nga i cili 8.800 milionë lekë financohet nga të ardhurat e privatizimit. Kufiri i financimit nga burimet e huaja është 26.722 milionë lekë, nga i cili mbështetje e drejtpërdrejtë për deficitin është 4.640 milionë lekë. Ligji bën edhe ndarjen e shpenzimeve sipas drejtimeve kryesore. Ai shoqërohet me mbi 250 faqe me tabela për ndarjen e buxhetit sipas ministrive e institucioneve, me detajimin e investimeve, shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik etj. Ligji ka 18 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.46/2000.

Ligji n.8719, datë 19.12.2000 “Për një shtesë në ligjin nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8473, datë 14.4.1999”. Me këtë ligj, në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë bëhet vetëm një shtesë. Kështu në pikën 4 të nenit 37 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8473, datë 14.4.1999, shtohet shkronja “C” me këtë përmbajtje:

“C. Pagesat për të drejtën e pronësisë intelektuale (royalties) dhe për të drejtën e licencës (licence fee) për filmat kinematografikë të importuar në Republikën e Shqipërisë, me të drejtën e riprodhimit dhe të shpërndarjes, nuk do t’i shtohen çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar”.

Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.47/2000, faqe 2074.

Ligji nr.8720, datë 26.12.2000 “Për krijimin e Policisë Financiare”.

Ky ligj ka për qëllim të luftojë dukuritë negative të shoqërisë shqiptare si kontrabandën, evazionin fiskal, pastrimin e parave etj. dhe në përgjithësi ka si detyrë themelore luftën kundër krimit ekonomik e financiar dhe njëkohësisht zbatimin me rreptësi të legjislacionit financiar, si dhe bashkëpunimin me institucione të tjera publike, private dhe në fushën ndërkombëtare. Kjo strukturë e re do të varet drejtpërdrejt nga Ministri i Financave dhe do të ketë në përbërjen e saj punonjës që ndahen në të mesëm, të lartë dhe madhorë. Pjestarët e Policisë Financiare do të kenë atributet e oficerit dhe agjentit të Policisë Gjyqësore. Detyrat konkrete të Policisë Financiare, përzgjedhja e drejtuesve të kësaj strukture dhe e drejtorit të përgjithshëm të saj, si dhe bashkëpunimi me strukturat e tjera të administratës financiare, parashikohet të zgjidhen me akte të Këshillit të Ministrave. Hartimi dhe miratimi i këtij ligji është përfshirë në matricën e planit të rishikuar antikorupsion dhe në angazhimet e Qeverisë Shqiptare ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Komisionit Europian. Ligji ka 16 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.2.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.50/2000, faqe 2153.

Ligji nr.8721, datë 26.12.2000 “Për një shtesë në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore””. Me këtë ndryshim të ligjit ekzistues rregullohet futja në skemën e ndihmës ekonomike të familjeve të personave invalidë. Deri tani pagesa që personat invalidë përfitojnë nga statusi i invalidëve llogaritet në bazë të të ardhurave të familjes,

prandaj është ndryshuar pika 6 e nenit 3 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”. Në pikën 6 thuhet: “Termi “e ardhura e familjes” nënkupon të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes, duke përfshirë edhe ata që përkohësisht jetojnë ose punojnë jashtë shtetit”. Me këtë ligj pas fjalëve: “... ose punojnë jashtë shtetit”, shtohen fjalët “me përjashtim të përfitimeve, në zbatim të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.48/2000, faqe 2079.

Ligji nr.8722, datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope””. Me këtë ligj është miratuar aderimi në Konventën kundër trafikut të paligjshëm nga ana e shtetit shqiptar. Kjo shënon fillimin e punës për pasurimin e legjislacionit shqiptar me akte ligjore kundër veprimtarive të paligjshme me drogën si në aspektin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar. Gjithashtu, duke u bërë pjesë e legjislacionit shqiptar, kjo Konventë do të shërbejë edhe si mbështetje për krijimin dhe pasurimin e legjislacionit penal, dhe jo vetëm të tij, për t’i dhënë shtetit dhe shoqërisë instrumente të domosdoshme të njohura ligjore në përballimin me sukses të kësaj lufte të vështirë. Ky aderim është edhe një konfirmim i vullnetit të Republikës së Shqipërisë për të qenë faktor veprues për sigurinë dhe stabilitetin në rajon. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.2.2001. Është botuar së bashku me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope në Fletoren Zyrtare nr.50/2000, faqe 2156.

Ligji nr.8723, datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e vetme mbi drogat narkotike, e ndryshuar nga protokollin i vitit 1972 për ndryshimin e Konventës së vetme mbi

drogat narkotike, 1961". Konventa synon kryesist në disiplinimin e veprimtarisë së prodhimit, të tregtimit dhe të përdorimit të lëndëve narkotike për qëllime shëndetësore dhe abuzive. Ajo përcakton organet ndërkombëtare të kontrollit të narkotikëve, të përgjegjësive dhe mënyrës së funksionimit të tyre, si dhe masat që do të merreshin në aplikimin e të drejtave dhe detyrimeve të shteteve firmëtare. Konventa përcakton dhe detyrimet e shteteve-palë për ngritjen e organizmave kombëtarë të ngarkuara me kontrollin e veprimtarive që kanë të bëjnë me bimët dhe lëndët narkotike. Për herë të parë janë përmbledhur dhe klasifikuar bimët narkotike kryesore si kanabisi, opiumi, bima e kokës, si dhe rregullat e procedurat për kultivimin e tyre, fabrikimin, transportimin dhe tregtimin ndërkombëtar dhe të brendshëm. I rëndësishëm është fakti se përcaktohen dispozitat penale për luftën kundër trafikut të paligjshëm dhe këto dispozita, edhe pse orientuese, janë mbështetje për legjislacionin penal të çdo shteti. Miratimi i këtij ligji për aderim në këtë Konventë shënon fillimin e plotësisht të zbrazëtisë që kishte legjislacioni ynë përse i përket luftës kundër drogës. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.2.2001. Është botuar së bashku me Konventën e Vetme mbi drogat narkotike, 1961 në Fletoren Zyrtare nr.50/200, f.2190.

Ligji nr. 8724, datë 26.12.2000 "Për ratifikimin e "Konventës Europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht"". Ratifikimi i kësaj Konvente me ligjin e lartpërmendur, lidhur me mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht, përbën një mekanizëm të rëndësishëm dhe të domosdoshëm në zhvillimin e të drejtës dhe shtetit ligjor. Konventa synon krijimin e një sistemi rehabilitues të frytshëm ndërshtetëror, me qëllim lehtësimin e detyrave të autoriteteve gjyqësore në dhënien e vendimeve dhe në ekzekutimin e sanksioneve për veprat penale. Gjithashtu, ratifikuesit e Konventës marrin përsipër të japin ndihmë të ndërsjellë, sipas parashikimeve të kësaj Konvente, për rehabilitimin shoqëror të keqbërëasve. Parashikohet që shkëmbimi i të

dhënave të realizohet nga një departament i Ministrisë së Drejtësisë. Përveç këtyre, në Konventë parashikohet në detaje përmbajtja e kërkesës për ekzekutimin e dënimeve, të dhënat që kërkohen për këtë gjë, sikurse të dhënat shtesë që mund të kërkohen nga palët, transmetimi i të dhënave dhe kërkesave, detyrimi për t'u përgjigjur nga ana e organit marrës dhe përjashtimet nga ky detyrim, afati i komunikimit të kërkesës, gjuhët në të cilat shkëmbehen të dhënat etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.2.2001. Është botuar së bashku me Konventën Europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht në Fletoren Zyrtare nr.50/2000, faqe 2234.

Ligji nr.8725, datë 26.12.2000 “Për një ndryshim në ligjin nr.8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira””. Ky ligj është inicuar nga një grup deputetësh. Në ligjin ekzistues ishte parashikuar që subjektet, që do të vepronin në këto zona, përjashtoheshin nga pagimi i tatimit mbi fitimin për 10 vjet. Në këto rrethana, inicuesit e konsideronin si një shmangie nga rregulli i përgjithshëm, që çdo subjekt, që realizon të ardhura, duhet të paguajë tatimin mbi fitimin dhe përveç kësaj, një përjashtim i tillë krijonte pabarazi ndërmjet subjekteve. Ligji i miratuar ndryshon pikën 3 të nenit 18 të ligjit nr.8636, datë 6.7.2000 dhe me këtë ndryshim nuk bëhet asnjë përjashtim nga pagimi i tatimit mbi fitimin edhe për subjektet që do të veprojnë në zonat e lira. Ligji ka 2 nene, ka hyrë në fuqi më 19.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.48/2000, faqe 2079

Ligji nr.8726, datë 26.12.2000 “Për mbulimin e detyrimeve të shtetit ndaj Bankës së Kursimeve sh.a. dhe rikapitalizimin e saj nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit”. Ligji rregullon probleme që kanë të bëjnë me procesin e ristrukturimit dhe të privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a. Nëpërmjet emetimit të bonos së thesarit, me kushte dhe terma tregtare nga ana e shtetit shqiptar, përmirësohet gjendja financiare e ksëaj banke, e cila, në procesin e privatizimit të saj, i rregullon situatën financiare dhe e bën më

tërheqëse në këtë proces. Ligji ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.12.2000. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.48/2000, faqe 2080.

Ligji nr.8727, datë 26.12.2000 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 13.12.2000 “Për përjashtimin nga TVSH-ja të gazit të lëngët e të pajisjeve që punojnë me gaz të lëngët dhe që përdoren për ngrohje dhe gatim””. Ligji miraton aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 13.12.2000. Me këtë akt përjashtohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit brenda vendit dhe të importit të gazit të lëngët dhe të pajisjeve që punojnë me gaz të lëngët e që përdoren për ngrohje dhe gatim. Ky përshtim është zbatuar vetëm për periudhën nga data 13.12.2000 deri në datën 30 prill 2001. Ligji ka hyrë në fuqi më 5.1.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.48/2000, faqe 2081.

Informacion mbi veprimtaritë e organizmave ndërkombëtare

Leon Shestani

ÇËSHTJET KYÇ TË MARRËVESHJES SË PAQES NË MAQEDONI (FYROM)

Marrëveshja e shumë diskutuar ndërmjet autoriteteve maqedonase dhe përfaqësuesve të shqiptarëve, ngjalli shumë pikëpyetje dhe vazhdon të mbajë pezull dhe sjelljen e bashkësisë ndërkombëtare për procesin e implementimit. Po cilat janë çështjet kyç që përbëjnë thelbin e kësaj marrëveshjeje?

